


بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



ASHURJA, MESAZH PËR REFORMIM DHE UNITET

Tiranë, 2023

Titulli i librit: **Ashurja, mesazh për reformim dhe unitet**

Përgatiti: **Haxhi Shejkh Vullnet MERJA**

Redaktoi: **Jerida KULLA**

Korrekttoi: **Ma. Isra MERJA**

Kopertina: **Ma. Isra MERJA**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "Flladi"**



PËRMBAJTJA

Dy fjalë për Imam Hysenin (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	9
Si e priste Ehli Bejti (<i>Paqja qoftë mbi ta!</i>) ardhjen e muajit muharrem?.....	12
Ndikimet e revolucionit të Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	14
Pikënisja e revolucionit të Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	17
Çdo vit përsëritet pyetja: Pse e kujtojmë betejën e Kerbelasë?.....	19
Pozita e Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) në Islam.....	21
Përse e kujtojmë Imam Hysenin (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)?.....	26
Fanari i udhëzimit dhe anija e shpëtimit.....	31
Ashurja, boshti i bashkimit mes sunive dhe shí'itëve.....	35
Ashurja, mesazh për reformim dhe unitet.....	39
Pas masakrës së Kerbelasë.....	44
Fatkeqësitë e zonjës Zejneb në Ditën e Ashures.....	48

I përjetshëm do të qëndrojë kujtimi i Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	50
Imam Hyseni (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>), simboli i unitetit.....	57
Pse ndodhi revolucioni në kohën e Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)?.....	60
Sqarim për agjërimin e Ditës së Ashures.....	64
Përkujtimi i Ashures së dhimbshme dhe ringjallja e saj është një ritual islam.....	70
Paqartësi dhe sqarime rreth Ashures.....	73
Imam Hyseni (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>), Kur'ani folës.....	81
Pjesë nga hytbeja e zonjës Zejneb, motra e Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>), në prani të Jezidit.....	90
Zonja Zejneb ishte zëri i Hysenit.....	96
Ana humane e ndodhisë së Kerbelasë.....	101
Çfarë bëri Ubejdullah ibn Zijadi?.....	111
Kush e vrau Imam Hysenin (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)?.....	113
Dita e Ashures, ditë madhështore.....	114
Përgjigje për pyetjet, drejtuar ndjekësve të Ehli Bejtit.....	117
Qyteti i Kufes në kohën e Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)...	125
Të dhëna rreth udhëtimit të Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	135



Çfarë pe në ziaretin e të dyzetave të Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)?.....	137
Kush është Muavia?.....	139
Bëmat e Muaviut në librat e Ehli Sunetit.....	144
Përshtypje për Jezidin, të birin e Muavias.....	148
Përgëzime shi'itëve.....	150
Ziareti i Imam Hysenit (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>).....	154
Lutje.....	159



DY FJALË PËR IMAM HYSENIN (*Paqja qoftë mbi të!*)

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është personalitet i shquar dhe i nderuar, mbartës i cilësive të larta. Ai është i biri i Imam Aliut, Prijësi i besimtarëve, i biri i Ebu Talibit. Nëna e tij, Fatime Zehraja, ishte e bija e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Gjyshja e tij ishte nëna e besimtarëve, hazreti Hatixheja (*Paqja qoftë mbi të!*).

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është nipi i dytë i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*), imami i tretë nga imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), i pesti i pjesëtarëve të mantelit, njëri nga dy borzilokët e të Dërguarit të Allahut dhe zotëria e të rinjve të banorëve të Xhenetit.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) lindi në ditën e tretë të muajit Shaban, katër vjet pas Hixhretit, në Medine. Ai u rrit dhe u edukua me besim dhe devotshmëri nga zemra e Imam Aliut dhe nga prehri i zonjës së madhe, Fatime Zehrasë. Udhëheqjen e filloi pas martirizimit të vëllait të tij,

Imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të!*). Udhëheqja e tij zgjati afërsisht 10 vjet.

Po përmendim disa prej mbiemrave, me të cilët thirrej: Es Sejjidi, Et Tajjibi, El Uefijju, El Mubareku, En Nafiu... etj.

Emër tjetër i tij: Ebu Abdullah

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte gjashtë fëmijë.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte një vend të veçantë tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Po përmendim një thënie të tij: *“Hyseni është prej meje dhe unë jam nga Hyseni. Allahu e do atë që e do Hysenin. Hyseni është nip prej nipave të mi”*.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) karakterizohej nga virtytet më të larta të moralit. U shërbente njerëzve dhe përpiquej me mish e me shpirt për t’u siguruar atyre ndihmë dhe mbrojtje. Një prej dhjetëra rasteve është edhe ngjarja me një beduin, i cili nuk ishte në gjendje të paguante paratë e gjakut që i kishte borxh. Imami bëri pagesën për të.

Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) merrte abdes, i ndryshonte ngjyra dhe i dridheshin duart. Një burrë i tha: *“Kaq shumë frikë ke nga Zoti yt!”*



Imami iu përgjigj: “Në Ditën e Kiametit askush nuk është i sigurt nga dënimi, përveç atij që i frikësohet Allahut në këtë jetë”.

Njerëzit e nderonin dhe e respektonin Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai u martirizua, më dhjetë Muharrem, të vitit 61, sipas kalendarit hënor (Hixhri) apo më 12 Tetor të vitit 680, sipas kalendarit Gregorian, pas namazit të drekës, në tokën e Kerbelasë në Irak, nga dora gjakatare e ushtrisë së Jezidit, i biri i Muavias, i privuar, i etur, i durueshëm dhe i shpërblyer. Ai ishte pesëdhjetë e tetë vjeç dhe u varros në Kerbela.

Paqja qoftë mbi Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*)!



SI E PRISTE EHLI BEJTI (Paqja qoftë mbi ta!) ARDHJEN E MUAJIT MUHARREM?

Tragjedia e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), bijve të tij të nderuar dhe e shokëve të tij besnikë (*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*) ka arritur deri në majat e qiellit. Aq e rëndë dhe aq e dhembshme ishte kjo tragjedi, sa për atë lotuan gjak qiejt dhe toka; çdo gjallesë qau për të; engjëjt e shtatë qiejve agjëruan; ujërat e deteve dhe të lumenjve pushuan së rrjedhuri dhe galaktikat pushuan së lëvizuri.

E si të mos ndodhte kështu, kur mishi i nipit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u copëtua në tokë dhe gjymtyrët e tij u prenë nga shpatat e njerëzve mëkatarë. As sytë nuk kanë parë të tillë tragjedi, as veshët nuk kanë dëgjuar e as nuk është menduar një tragjedi e tillë. Muaji Muharrem është muaj pikëllimi për Ehli Bejtin (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Imam Ali Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur hynte muaji Muharrem, Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk qeshte. Hidhërimi e pushtonte atë, deri sa kalonin dhjetë



ditët. Kur vinte dita e dhjetë (e muajit Muharrem, Ashurja), ajo ditë ishte për të dita e fatkeqësisë, e pikëllimit dhe e të qarit. Ai thoshte: 'Kjo është dita, kur u vra Hyseni (Paqja qoftë mbi të!)''.



NDIKIMET E REVOLUCIONIT TË IMAM HYSENIT (*Paqja qoftë mbi të!*)

Revolucioni i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) është një nga ngjarjet më frymëzuese, më shpresëdhënëse, më rrënjëthënëse, më pikëlluese dhe më ndikuese në historinë njerëzore. Kjo tragjedi përkujtohet çdo vit nga besimtarët myslimanë dhe veçanërisht nga dashamirësit dhe pasuesit e Ehli Bejtit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Ky përkujtim quhet matem. Matem është fjalë perse, që në gjuhën shqipe do të thotë zimbajtje, e cila mbahet në përkujtim të betejës së Kerbelasë, që u zhvillua ndërmjet ushtrisë së Jezidit, i biri i Muavias, nën komandën e Ubejdullah ibn Zijadit dhe ndërmjet Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), së bashku me familjen dhe shokët e tij.

Në këtë betejë të përgjakshme ra dëshmor Hyseni, i biri i Aliut, nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), së bashku me 72 dëshmorë të tjerë prej familjes dhe shokëve të tij, mes tyre edhe foshnja gjashtëmuajshe, djali i Imam Hysenit, Abdullahu.

Kerbelaja ndodhet në jug të Bagdadit, kryeqyteti i Irakut. Largësia mes Bagdadit dhe qytetit të Kerbelasë është afërsisht 105 kilometra. Kerbelaja hyn në kategorinë e vendeve të shenjta për besimtarët myslimanë, pas Mekës, Medinës, Jerusalemit (Kudsit) dhe Nexhefit.

Beteja e Kerbelasë dhe revolucioni i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) pati dhe vazhdon të ketë ndikim të madh, jo vetëm te myslimanët, por edhe te popujt e tjerë, me besime të ndryshme. Gjithashtu, edhe te personalitetet e shquara botërore, në Lindje apo në Perëndim, të cilët flasin me admirim e respekt të madh për këtë betejë dhe për personalitetin e lartë të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Mahatma Gandhi (1869-1948), udhëheqësi politik dhe shpirtëror i Indisë, ka thënë: “E kam studiuar me detaje jetën dhe veprën e dëshmorit të madh islam, Imam Hysenit. Pas një leximi të kujdesshëm, beteja e Kerbelasë, më mësoi se, nëse India dëshiron të arrijë fitoren, duhet të ndjekë rrugën dhe shembullin e Hysenit...”

Kryengritja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) është një epike humane dhe shpirtërore, e cila, pavarësisht shekujve që kanë kaluar, ende vazhdon të shpërthejë emocione dhe të ndezë ndjenja. Ai, së bashku me shokët dhe familjen e tij, duruan dhimbjet dhe torturat më të tmerrshme.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), me gjithë mundësitë e tij të kufizuara dhe mungesës së përkrahësve, qëndroi i palëkundur dhe dha mësimin më të mrekullueshëm të sakrificës dhe të flijimit. Revolucionarët u frymëzuan nga shpirti i qëndrueshmërisë dhe i guximit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) gjatë gjithë kohëve.

Kryengritja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte dimension politik. Ai është një revolucion kundër tiranisë, padrejtësisë dhe shthurjes. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ngriti parullën e reformës. Ai bëri thirrje për liri dhe refuzoi poshtërimin dhe nënshtrimin.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk kërkon dikë që të qajë për të, por dëshiron që dikush të ndjekë rrugën e tij në forcimin e marrëdhënieve me Allahun dhe respektimin e të drejtave të robëve të Tij.

Paqja qoftë mbi Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe dëshmorët e Kerbelasë!

Mallkimi i Allahut qoftë mbi vrasësit e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*)!



PIKËNISJA E REVOLUCIONIT TË IMAM HYSENIT (*Paqja qoftë mbi të!*)

Në suren “Ali Imran”, në ajetin 104, thuhet:

﴿وَلْتَكُنْ مِنْكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ ۗ وَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ﴾

“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”

Kjo ishte pikënisja e Revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai u ngrit që të mbrojë mesazhin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), pasi ai mesazh u përball me egoistët dhe të eturit për pushtet dhe me shtypësit e njerëzve. Ai u ngrit për t’u shërbyer interesave të mesazhit islam dhe nuk u ngrit për interesat e tij vetjake.

Revolucioni i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) u bë për të ruajtur minberin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), mbi të cilin

vazhdojnë të mbahen leksione e hytbe të ndryshme. Revolucioni i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) bazohet te sinqeriteti. Në atë revolucion të begatë, myslimani ndien frymën e besimit të vërtetë, krenarinë e shpirttrave dhe dinjitetin e umetit, që është një aspekt i rëndësishëm i arsyeve të revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).



ÇDO VIT PËRSËRITET PYETJA: PSE E KUJTOJMË BETEJËN E KERBELASË?

Në fakt, marrëdhënia jonë me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) shkon përtej të qenit revolucionar, reformator, sakrifikues dhe bamirës. Është marrëdhënia e xhematit me imamin, të cilin e ndjekin dhe marrin prej tij fjalët, veprimet dhe udhëzimet. Ai xhemat duhet të njihet me atë që bëri Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të përpiqet me sa mundet të jetë përkrahës i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), duke kundërshtuar padrejtësinë dhe të padrejtët.

Prandaj, ne e rikujtojmë betejën e Kerbelasë, për ta jetuar atë brenda vetes sonë, për të parë përmes saj, se ku jemi ne me kënaqësinë e Allahut, me të vërtetën, me drejtësinë dhe me çdo gjë që ishte i interesuar Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*). Në ato momente, midis të tjerash, Imam Hyseni, ka thënë: “Këta njerëz i binden shejtanit dhe e kanë braktisur bindjen ndaj të Gjithëmëshirshmit, shfaqën shturjen dhe prishën kufijtë, parapëlqyen këtë botë; e bënë hallall atë që Allahu e ka bërë haram (e ka ndaluar) dhe e

bënë haram (të ndaluar) hallallin (të lejuarën) e Tij. Unë duhet ta pastroj këtë llum!”.

Kur vjen dita e përkujtimit të betejës së Kerbelasë, duhet të hyjmë në të me mentalitetin e reformatorëve dhe të ndryshuesve. Të mos pranojmë shturjen, padrejtësinë dhe devijimin. Të mos i lavdërojmë të shtururit, zullumqarët dhe të devijuarit, të mos i mbështesim, të mos justifikojmë veprimet e tyre dhe të mos i bëjmë të ndihen të sigurt.

Le t'i përmbahemi porosisë së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familje e tij!*): “Ai që sheh një sulltan tiran, që e ka bërë hallall haramin e Allahut, thyen besëlidhjen e Tij, vepron në kundërshtim me Sunetin e të Dërguarit të Allahut, vepron me robtë e Tij me mëkat dhe agresion, nëse nuk e ndryshon me fjalë e as me vepër, është e drejtë e Allahut që ta fusë në Xhehenem”.

Paqja qoftë mbi Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe mbi dëshmorët e Kerbelasë!

Respekt e nderime pafund për të gjithë ata që mbajtën të ndezur pishtarin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) në trojet shqiptare: hoxhallarë, baballarë, shehlerë, muhiba e dervishë.



POZITA E IMAM HYSENIT (*Paqja qoftë mbi të!*) në Islam

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) lindi, më 3 Shaban në vitin e katërt Hixhri. Familja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e priti me gëzim dhe me lumturi lindjen e tij. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sapo i mbërriti lajmi se Fatimja lindi djalë, shkoi si era në shtëpinë e saj, për ta uruar për vogëlushin e lindur dhe e quajti Hysen.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u rrit në prehrin e gjyshit të tij, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në mesin e Aliut dhe Fatimes (*Paqja qoftë mbi ta!*). Ai u ushqye me moralin e profetësisë dhe u edukua me parimet e larta islame, me parimet e drejtësisë e të së vërtetës.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kujdesej shumë për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ishte i vogël. Ai e mbante në krahë atë, së bashku me vëllain e tij, Imam Hasanin (*Paqja qoftë mbi*

ta!) dhe, në prani të shokëve të tij, thoshte: “O Zot, unë i dua këta dy djem dhe e dua atë që i do ata. Kush e do Hasanin dhe Hysenin, më do mua dhe, kush i urren ata, më urren mua”.¹

I Dërguari i Allahut ka thënë: “Hasani dhe Hyseni janë dy borzilokët e mi prej borzilokëve të dynjasë”.²

Një ditë, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) po falej dhe Hasani dhe Hyseni u ngjiten në shpinën e tij. Njerëzit i larguan ata, kurse ai u tha atyre: “Lërinia ata, se ata janë të shtrenjtë për mua. Ai që më do mua, le të dojë këta të dy”.³

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Kush dëshiron të shohë një prej banorëve të Xhenetit, le të shikojë Hysenin”.⁴

Ebu Bekri ka thënë: “Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, të thotë: ‘Hasani dhe Hyseni janë zotërinjtë e banorëve të Xhenetit’”.⁵

Në “Sahihun” e Tirmidhiut është një hadith, që Ja’la El Amiri e ka transmetuar nga Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): “Hyseni është

¹ Muhibudijn et Tabari, “Dhehairul Ukba”, f. 124.

² “Sahihul Bukhari”, (4/217), (7/74); “Sunen Et Tirmidhi”, 5/322; “Sunen ebi Daud”, 261; “Sunen Ebi Ja’la”, 10/106; “El Mu`xhemul Kebijr”, 3/127; “Musned Ahmed”, 2/85, 93, 114, 153.

³ Muhibudijn et Tabari, “Dhehairul Ukba”, f. 124, 129.

⁴ “Sahihul Bukharij”: faqe ose numri 1397.

⁵ Muhibudijn Tabari, “Dhehairul Ukba”, f. 124. Gjithashtu në f. 129.

prej meje dhe unë jam prej Hysenit. Allahu e do atë që e do Hysenin. Hyseni është prej degëve të asaj peme”.

Selman El Farisi ka transmetuar fjalën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Hasani dhe Hyseni janë bijtë e mi. Kush i do ata të dy, më do mua dhe, kush më do mua, e do Zotin e Madhëruar dhe atë që Zoti e do, e fut në Xhenet. Kush i urren ata të dy, më ka urryer mua dhe, kush më urren mua, ka urryer Zotin dhe atë që Zoti e urren, e fut në Xhehenem”.⁶

Këtë vend të veçantë zinte Hyseni në zemrën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, pasi ai u rrit në shtëpinë më bujare, më fisnike, më famëlartë, në shtëpinë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Me atë personalitet të lartë që kishte, me pozitën e lartë që zinte në shoqëri, Hyseni u bë fuqi ndikuese në ndërgjegjen e historisë islame.

Myslmanët besojnë në dashurinë për Ehli Bejtin në përgjithësi dhe në dashurinë për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Ata e donin Hysenin, e duan dhe do të vazhdojnë ta duan atë, sepse ai është prej imamëve me prejardhje nga

⁶ “Y’lamul Uara”, f. 219.

Ehli Bejti i pastër i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Prandaj, vrasja e tij është fatkeqësi dhe humbje për të gjithë umetin islam, jo vetëm për një pjesë të myslimanëve. Për këtë, është detyrë e të gjithë myslimanëve që ta kujtojnë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse ai nuk është pronë private e askujt.

Dashuria dhe respekti që kishin, kanë dhe do të kenë myslimanët për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) e ka filluesen në Kur'an, sepse Allahu i Madhëruar urdhëroi për dashurinë e Ehli Bejtit dhe Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është njëri prej tyre.

Allahu i Madhëruar, në Kur'anin e Shenjtë, thotë: **“Thuaj: ‘Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen Time, por vetëm respektin e dashurinë për hir të të afërmve (akraballëkut)...”**⁷

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) rrjedh nga Ehli Bejti, të cilët Allahu i ka pastruar prej ndyrësive të gjynaheve. Në suren “El Ahzab”, në ajetin 33, thuhet: **“Allahu ka për qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë së Pejgamberit, të largojë ndyrësitë e gjynaheve dhe t’ju pastrojë deri në skaj.”**.

⁷ Sure “Esh Shura”, ajeti 23.



Kur ndodhi ngjarja e Mubahesë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte së bashku me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Imam Aliun, Fatime Zehranë dhe Imam Hasanin (*Paqja qoftë mbi ta!*). Për këtë ngjarje zbriti ajeti: **“E kush të kundërshton ty në çështjen e Isait, pasi të është bërë e ditur e Vërteta, ti thuaj: ‘Ejani të ftojmë bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, vetet tona dhe vetet tuaja, pastaj, sinqerisht, të lutemi për mallkim dhe mallkimin nga ana e Allahut ta hedhim kundër gënjeshtarëve.”**⁸

Por ama, është për të ardhur keq se të gjitha këto thënie që u përmendën, e shumë e shumë thënie të tjera që gjenden në literaturat islame, u harruan dhe përfundimi ishte ndodhia e masakrës së Kerbelasë, e cila nuk ka të ngjashme në historinë e njerëzimit.

⁸ Sure “Ali Imran”, ajeti 61.



PËRSE E KUJTOJMË IMAM HYSENIN (Paqja qoftë mbi të!)?

Në suren “Haxhah”, në ajetin 32, thuhet:

هُرْمَن يُعْظِمُ شَعْبَ اللَّهِ فَإِنَّمَا مِنْ تَقْوَى الْقُلُوبِ

“Kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.”

Pasi lexon këtë ajet, para nesh dalin disa detyra. Po përmendim disa prej tyre.

Së pari: Ne zbatojmë urdhrin e Allahut të Madhëruar. Në lidhje për këtë çështje, në suren “Esh Shura”, në ajetin 23, thuhet: **“Nuk ju kërkohet për këtë kurrfarë shpërblimi, përveç se dashurisë ndaj të afërmve.”**

Ky ajet ka zbritur për Ehli Bejtin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për një nga pjesëtarët e Ehli Bejtit, për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Është e natyrshme se, kur një person e do një tjetër, me dashuri të pastër e të sinqertë, ai kurrë nuk e

harron atë dhe e kujton gjithmonë. Të tillë janë edhe dashamirësit dhe ndjekësit e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Së dyti: Me përmendjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ne përkrahim të drejtën dhe e ringjallim atë. Kundërshtojmë padrejtësinë dhe tiraninë dhe përpiqemi t'i çrrënjosisim ato nga shoqëria. Për këtë, Allahu ka urdhëruar, që të zbatojmë urdhëresat e Tij dhe të ndalojmë veprimin e veprave të këqija. Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin, (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.”**⁹

Së treti: Me përmendjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ne përhapim Islamit që solli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e mbarti familja e tij e pastër, Ehli Bejti, në përgjithësi dhe Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), në veçanti, i cili sakrifikoi gjithçka për ruajtjen e Islamit.

Së katërti: Me përmendjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ne sqarojmë rrugën tonë dhe medresenë tonë, e cila është medreseja e Ehli Bejtit të pastër e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kjo është medrese gjithëpërfshirëse për të gjitha shtresat, medh'hebet, tarikatet dhe grupet. Është medreseja

⁹ Sure “Ali Imran”, ajeti 110.

më e pasur me dije e njohuri islame. Medreseja e Ehli Bejtit është streha e bashkimit, e vëllazërimit, e unitetit dhe e vlerave të larta morale dhe humane. Ajo është anija e shpëtimit për të gjithë myslimanët, madje edhe për të gjithë njerëzimin.

Së pesti: Ne e përmendim Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Ashuren për ta ruajtur nga humbja dhe nga falsifikimi prej duarve, mendjeve dhe gjuhëve dashakeqëse. Po të mos ishin këto ceremoni të përvitshme, që organizohen për të kujtuar Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Ashuren, jo vetëm që do të mohohesh nga shumë kundërshtarë, por do të fshihej dhe do të harrohej si ngjarje.

Së gjashti: Ne e kujtojmë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse zbatojmë porosinë e Kur'anit: **“Kush i madhëron simbolet e Allahut, ajo është prej devotshmërisë së zemrave.”**¹⁰ Padyshim që Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është prej simboleve të Allahut, sepse ai jetoi për Allahun dhe u martirizua për të mbrojtur fenë e Allahut.

Së shtati: Ne e kujtojmë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse zbatojmë porosinë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Ju porosis për Ehli Bejtin tim”**; **“Më ndiqni mua nëpërmjet Ehli Bejtit tim”**.

¹⁰ Sure “Haxhxh”, ajeti 32.

Së teti: Ne e kujtojmë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse zbatojmë thënien e Imam Rizait: “Ringjalleni çështjen tonë. Allahu e mëshiroftë atë që e ringjall çështjen tonë. Sikur njerëzit të njihen me thëniet tona të bukura, ata do të na ndiqnin”.¹¹ Pra, të kujtosh Ehli Bejtin, në përgjithësi dhe Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), në veçanti, do të thotë të jesh i mbështjellë me mëshirën e Allahut të Madhëruar.

Së nënti: Ne e kujtojmë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse ai përfaqëson drejtësinë, lirinë, humanizmin, moralin e lartë, besimin e pastër. Me ripërtëritjen e përmendjes së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ringjallen vlerat e larta shpirtërore, shpirti i përpjekjes dhe i sakrificës për mbrojtjen e parimeve fetare, morale dhe humane në shoqëri.

Së dhjeti: Ne e kujtojmë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), që t’u themi jezidëve të çdo kohe se Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është i gjallë dhe kurrë nuk vdes. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Vrasja e Hysenit është një nxehtësi në zemrat e besimtarëve, e cila kurrë nuk ftohet.”.¹²

¹¹ “Biharul Anuar”, vëll. 2, f. 30.

¹² “Mustedreku Uesailu Shiati”, vëll. 10, f. 318.

Allahu na forcoftë në rrugën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), në këtë jetë dhe na bashkoftë me të në Jetën Tjetër!

Paqja qoftë mbi Imam Hysenin!



FANARI I UDHËZIMIT DHE ANIJA E SHPËTIMIT

Falënderimi i takon Allahut, Sunduesit të botëve. Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi Profetin Muhamed dhe familjen e tij të pastër, mbi shokët e tij të zgjedhur dhe mbi të gjithë të Dërguarit dhe Profetët!

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Hyseni është fanar udhëzimi dhe anije shpëtimi.*”¹³

Nëse thellohem në kuptimin e këtij hadithi, do të mësojmë se njeriu në këtë botë ka nevojë për:

1- Fanar ndriçimi e udhëzimi, që të shikojë rrugën, në të kundërt do të humbasë në terrin e injorancës, sëmundjes e varfërisë dhe do të bjerë në humnerën e devijimit e të shkatërrimit. Duke qenë në errësirë, ai nuk i sheh bishat dhe egërsirat që dëshirojnë ta shqyejnë. Nuk i sheh as akrepat dhe gjarpërinjtë që duan ta pickojnë, që ai të ruhet prej tyre. Nuk e sheh atë që dëshiron ta shkatërrojë e ta poshtërojë.

¹³ “Biharul Enuar”, vëll. 376, Hadithi 8, f. 205, Botuar në Bejrut.

2- Gjithashtu, njeriu ka nevojë për një anije, për ta mbrojtur atë nga mbytja dhe nga përplasjet e dallgëve të forta të kësaj bote. Ka nevojë për anije, që ta çojë atë në bregun e lumturisë, të sigurisë dhe të paqes.

Pyes veten: Vallë kush është ky fanar për ta udhëzuar e për ta ndriçuar njeriun në këtë botë? Cila është anija që e shpëton njeriun nga dallgët dhe errësira e kësaj bote? Askush tjetër nuk mund të jetë përveç atyre që janë përcaktuar nga Shpallja dhe që na i ka treguar i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ata janë Ehli Bejti i tij i pastër, për të cilët, në ajetin 33 të sures “El Ahzab”, thuhet:

﴿...إِنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيُذْهِبَ عَنْكُمُ الرِّجْسَ أَهْلَ الْبَيْتِ وَيُطَهِّرَكُمْ تَطْهِيرًا...﴾

“...O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht...”

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është një nga pjesëtarët e Ehli Bejtit të pastër e të pagabuar, të cilët janë anije shpëtimi dhe fanar udhëzimi. Profeti Muhamed (*Paqja bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Ehli Bejti im është si yjet. Këdo prej tyre të ndiqni, do të jeni të udhëzuar.”¹⁴

¹⁴ Shejkh Tusi, “Amalij”, vëll. 1, f. 265.

Gjithashtu, në lidhje për këtë çështje, ka thënë: *“Shembulli i Ehli Bejtit tim është si anija e Nuhut. Kush hipi në të, shpëtoi e, kush kundërshtoi të hipë në të, u mbyt.”*¹⁵

Dy cilësitë: fanari ndriçues dhe anija e shpëtimit, janë për secilin prej katërmbëdhjetë të pagabuarve: Profetin Muhamed, Aliun, Fatimen, Hasanin, Hysenin, Sexhadin, Bakirin, Sadikun, Kadhimin, Rizain, Xheuadin, Hadin, Askeriun dhe Mehdiun (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është fanari më madhështor dhe anija më gjithëpërfshirëse, për të cilin Allahu i Madhëruar, në ajetet 45-46 të sures “El Ahzab”, thotë:

﴿ يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَاهِداً وَمُبَشِّراً وَنَذِيراً ۖ وَدَاعِياً إِلَى اللَّهِ بِإِذْنِهِ وَسِرَاجاً مُنِيراً ﴾

“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në Rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.”

Njerëzimi jeton sot në errësirën e plotë të “injurancës moderne”. Dallgët e jetës e kanë çuar atë buzë greminës së kaosit, trazirave, shqetësimeve, problemeve, fatkeqësive dhe ankthit. Nuk ka shpëtim për të, nëse dëshiron të mbijetojë, përveçse të ndriçohet me dritën e këtyre njerëzve

¹⁵ Es Sujutij, “Tarijkhul Khulefa”; Ibn Tejmije, “El Mearif”; Ibn Haxhr, “Es Seuauku”, vëll. 11, K. 2.

të pastër dhe të hipë në anijen e tyre. Ata janë të pandarë nga Libri i Allahut, siç ka thënë Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): “Unë po ju lë juve dy gjëra me peshë të madhe për nga rëndësia. Nëse ju do të kapeni pas këtyre, nuk do të humbisni kurrë. Njëra prej tyre është më madhështore se tjetra: Libri i Allahut, një litar që zgjatet nga qielli në Tokë dhe pasardhësit e mi, Ehli Bejti im. Ata nuk ndahen, deri sa të ktheheni te Hauzi (burimi Keuther). Prandaj, hapini sytë, se si do të më kundërshtoni mua me këto të dyja.”¹⁶

Në suren “El A’raf”, në ajetin 43, thuhet:

﴿...الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي هَدَانَا لِهَذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِيَ لَوْلَا أَنْ هَدَانَا اللَّهُ...﴾

“...Qoftë lavdëruar Allahu që na udhëzoi në këtë. Ne nuk do të ishim udhëzuar, sikur të mos na udhëzonte Allahu...”

¹⁶ En Nisai, “El Khasaisu”; “Musned Ahmed”, vëll. 3; “Sahihu Muslim”, vëll. 7; Sujuti, “Ed Durr’rrul Menthur”, vëll 2.



ASHURJA, BOSHTI I BASHKIMIT MES SUNIVE DHE SHI'ITËVE

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u sakrifikua për hir të Islamit të vërtetë që solli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në mesin e shokëve të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte prej atyre që nuk ishin shi'itë, në kuptimin e fjalës që qarkullon sot. Përveç kësaj, Imam Hyseni kishe shokë, si Uehbi, i cili nuk ishte mysliman, por e mbështeti dhe e përkrahu Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e përqafoi Islamit në këtë rrugë.

Disa nga shokët e Imam Hysenit, si: Zuhejri apo El Hurri, nuk morën parasysh besimin e tyre, edhe pse nuk ishin shi'itë (në kuptimin e fjalës që qarkullon sot), nuk kishin pranuar udhëheqjen e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut, i qëndruan pranë atij deri sa ranë dëshmorë.

As ne, pasuesit (shi'itët) e Ehli Bejtit, nuk kemi të drejtë ta monopolizojmë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) vetëm për veten tonë, as vëllezërit tanë suni nuk duhet ta

neglizhojnë e as ta harrojnë çështjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të mos e konsiderojnë si çështje të shi'itëve.

Ashurja është boshti i bashkimit mes shi'itëve dhe sunive, kështu që ne duhet ta mbajmë zënë për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) në një atmosferë vëllazërie islame.

Nuk ka dyshim se shi'itët janë krenarë për imamin e tyre të tretë, Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Por shi'itët nuk janë të vetmit që krenohen me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*).

Esh Shafi'i, një nga juristët e katër medh'hebeve të Ehli Sunetit, ka thënë fjalë të mrekullueshme për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), madje ai e vajtonte atë më shumë se disa shi'itë. Zimbajtja për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) është një ritual i njohur në mesin e shumë sunive.

Armiqtë e Islamit kërkojnë pikat e dobëta të umetit islam dhe punojnë për t'i forcuar ato, duke ngritur shkolla dhe rryma ideologjike për të vrarë vajtuesit e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ashurja është tragjedi islame dhe jo thjesht shi'ite. Në ditët tona, kur flitet për këtë tragjedi me njerëzit e drejtë e të ditur të botës apo me vëllazërit tanë suni, shihet pranimi dhe reagimi pozitiv i tyre ndaj kësaj tragjedie.

Dijetarët e Ehli Sunetit kanë shkruar libra për vrasjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Pra, shikoni se si ka qenë atmosfera gjatë historisë, ku të gjithë do të dëshironin të shoqëroheshin, në një mënyrë apo në një tjetër, me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe t'i afroheshin atij qoftë me shkrime librash, qoftë me përcjelljen e tragjedisë së Kerbelasë.

Të mos harrojmë se një prej veprave që mbajtën gjallë Islamin në trojet shqiptare gjatë kohës së errët komuniste, është edhe mbajtja zi për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo i atribuohet dijetarëve, baballarëve, shehlerëve e dervishëve. (*Allahu i pastë mbuluar me mëshirën e Tij!*).

Duhet të mendojmë se cila është detyra jonë, sot, ndaj tubimeve të zimbajtjes për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*)? Ne duhet ta përçojmë zërin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) në veshët e të gjithë njerëzve të botës, duke organizuar tubime të ndryshme, përmbajtja e së cilave të jetë me këshilla e porosi larg legjendave. Nuk është e saktë që mbajtja zi për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) të konsiderohet ceremoni shi'ite. Ajo është ceremoni edhe për sunitë.

I ftoj të gjithë ata që kanë marrë mbi supë përhapjen e mesazhit islam, që të jenë të drejtë ndaj tragjedisë së Kerbelasë dhe të mos e etiketojnë si tragjedi, që i përket vetëm dashamirëve të Ehli Bejtit. Nëse dëshironi të



përfshiheni në shefatin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), atëherë thoni të vërtetën e masakrimit të nipit të tij, Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).



ASHURJA, MESAZH PËR REFORMIM DHE UNITET

Ashurja është shkollë e reformimit dhe e unitetit. Ajo përcjell mesazhe të shumta e të vlefshme për çdo kohë dhe për çdo brez. Nuk mund të jesh me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ti i bën padrejtësi gruas tënde, fëmijëve, fqinjëve, punonjësve të tu apo dhe njerëzve që të rrethojnë.

Nëse doni të ndani me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) disa nga plagët e tij, atëherë jini me të vërtetën, me të drejtën dhe kundër të pavërtetës e të padrejtës.

Thirrja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*): “Unë dola për të kërkuar reformë në umetin e gjyshit tim”, duhet të zbatohet edhe sot, për të ndrequr e për të reformuar dobësitë e umetit islam. Jo vetëm kaq, por për të zhdukur mospajtimet që kanë çuar në ndarjen e myslimanëve nga njëri-tjetri. Duhet ta vendosim Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) në zemrat tona, që të dëbojmë urrejtjen ndaj të tjerëve.

Vajtimi për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk është i mjaftueshëm. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk

ka nevojë për atë (vajtimin). Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është dëshmor i reformimit. Nëse jemi me Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) në reformimin e umetit të gjyshit të tij, jemi prej përkrahësve dhe ndihmësve të tij. Nëse heshtim ndaj reformimit apo e pengojmë atë, ne e kemi poshtëruar Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ashurja nuk është për të ata me vizion të ngushtë, as për fanatikët, por është pikënisje për liridashësit, të cilët e marrin Ashuren si pikënisje të sakrificës së tyre për liri, në luftën kundër shtypësve dhe të padrejtëve.

Ndoshta nuk gjejmë në realitetin islam një çështje që të ketë ndikim dhe përmasa në mendje, në zemër, në tradita, në lëvizje dhe në parulla, siç është çështja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), e cila vazhdon të ndikojë në shoqërinë islame, që nga e kaluara, në të tashmen e do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Shtypësit dhe të padrejtët përfitojnë nga shumica e heshtur. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) na jep legjitimitet dhe një shembull për të qenë të hapur ndaj realitetit tonë, duke refuzuar gjendjen e neutralitetit midis së mirës dhe së keqes.

Le ta bëjmë ndodhinë e Ashures një ritual bashkimi, në nivelin islam dhe njerëzor. Imam Hyseni, me gjithçka që simbolizon, është boshti i unitetit. Ai është imami i të gjithë

muslimanëve dhe imami i çdo të liri e të nderuari. Parullat e tij nuk ishin asnjëherë sektare, por islame dhe njerëzore.

Le t'i ruajmë qëllimet e Ashures dhe ta zgjerojmë rrethin e saj, në mënyrë që ajo të jetë islame, madje edhe humane; të hyjë në ndërgjegjen dhe mendjen e individit. Nuk duhet ta zbehim atë e as ta burgosim në rrethet tona të vogla dhe të ngushta, duke harruar apo duke anashkaluar të gjitha qëllimet e saj të mëdha.

Kurrë të mos mendohet se Ashurja është ritual i një grupi, kundër një grupi muslimanësh, sepse Jezidi nuk e përfaqëson Ehli Sunetin dhe ata i dënojnë me forcë veprat e tij tirane.

Ashurja mbart brenda saj të vërtetën, drejtësinë, të gjitha lëvizjet e përgjegjshme në rrugën e mirësisë, të gjithë shpirtëroren, e tejmbushur me përkushtim ndaj Krijuesit, të gjitha sakrificat në mbrojtje të vlerave të larta humane, dashurinë e thellë dhe besimin e patundur.

Ashurja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) vazhdon të frymëzojë çdo gjeneratë, me mendim të vetëdijshëm, që është i hapur për të gjitha çështjet e jetës. Vazhdon t'i frymëzojë ata në çdo lëvizje, që ka për qëllim Islamin, vijën e drejtësisë dhe të lirisë. Vazhdon t'i frymëzojë ata, në dëshirën për ndryshim, drejt asaj që është më e mira. Vazhdon t'i frymëzojë ata, me shpirtin adhures e

përkushtues, që fluturon në hapësirën e gjithësisë së Krijuesit dhe afrohet më pranë Tij.

Suksesi i Ashures nuk gjendet te sasia e lotëve që derdhen në të, por te madhësia e qëllimeve që arrihen në të. Përkujtimi i Ashures duhet të jetë një çështje, për të thirrur në Islam, e cila është feja e paqes, e vëllazërisë e respektit dhe e bashkëpunimit me njëri-tjetrin, me mirësi e dashamirësi. Është fe që fton në drejtësi, në solidaritet dhe kundërshton çdo gjë të keqe, të neveritshme dhe shkatërruese, siç thuhet në Kur'an, në suren "En Nahl", në ajetin 90: **"Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t'ia vini veshin."**

Ai që është me Kerbelanë e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk mund t'i japë besën të padrejtit. Ai që është me Kerbelanë e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk mund të luftojë përkrah të padrejtit, as nuk mund të justifikojë padrejtësinë e të padrejtit dhe as nuk mund ta ndihmojë atë, sepse Allahu, në suren "Hud", në ajetin 113, thotë: **"Dhe mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t'ju përcëllojë Zjarri. Ju nuk do të keni mbrojtës tjetër përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni."**

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) përfaqëson një vijë, një metodologji dhe një mishërim të gjallë të vlerave islame dhe njerëzore të dinjitetit, krenarisë dhe ruajtjes së

palëkundëshmërisë në rrugën e vlerave të larta njerëzore. Kurrë nuk do të jemi hysenianë, nëse jemi prej atyre që mbajmë qëndrim indiferent ndaj çdo të mire që nuk veprohet dhe ndaj çdo të keqeje që nuk ndalohet.



PAS MASAKRËS SË KERBELASË

Kur gratë dhe vajzat e familjes së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të dëshmorëve të Kerbelasë i futën në Damask, ato i sollën rreth e rrotull rrugës që të çonte te pallati i të poshtrit, tiranit, Jezidit. Së bashku me to ishin edhe kokat e dëshmorëve, të vendosura mbi shtiza.

Pastaj ato i vendosën në një verandë të madhe që ndodhej para xhamisë “El Xhamiu”, ku vendosnin vajzat e jobesimtarëve dhe i reklamnin për shitje, në mënyrë që namazfalësit, kur të hynin dhe kur të dilnin nga xhamia, t’i shikonin ato. Në këtë mënyrë ata zgjidhnin kë të donin për ta blerë dhe për ta punësuar.

Ata që e quanin veten e tyre myslimanë dhe ishin prej umetit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), e vendosën familjen e tij në atë verandë. Oh çfarë fatkeqësie! Oh, çfarë vuajtje! Oh, çfarë dhimbje!

Një i moshuar iu afrua grave të Hysenit.



- Falënderojmë Allahun që ju vrau, - u tha i moshuari atyre, - ju shkatërroi, që “rehatoi” burrat tuaj dhe i dha mundësi prijësit të besimtarëve të merrte masa ndaj jush.

- O xhaxha. A e ke lexuar Kur'anin? - i tha Ali ibn Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

- Po, - iu përgjigj i moshuari.

- A e ke lexuar këtë ajetin: **“Nuk ju kërkoi për një gjë të tillë shpërblim, veçse dashuri për të afërmit.”**? - e pyeti Ali ibn Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

- Po. E kam lexuar.

- Ne jemi të afërmit, o xhaxha!

- A e ke lexuar ajetin: **“E jepua të drejtën të afërmeve?”**

- Po. E kam lexuar këtë.

- Ne jemi të afërmit, o xhaxha!

- A e ke lexuar ajetin: **“Ta dini se çfarëdo që të fitoni si plaçkë lufte, një e pesta i takon Allahut, të Dërguarit dhe të afërmeve të tij...”**?

- Po. E kam lexuar.

- Ne jemi të afërmit, o xhaxha! A ke lexuar ajetin: **“O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht.”?**

- Po. E kam lexuar.

- Ne jemi Ehli Bejti, të cilët Allahu i ka veçuar me ajetin e pastrimit, o xhaxha.

I moshuar heshti i penduar nga ajo që tha.

- Betohem në Allah! Pse, ju jeni ata?!- tha i habitur i moshuari.

- Betohem në Allah, se ne jemi ata dhe në këtë nuk ka asnjë dyshim.

I moshuari qau dhe e hodhi çallmën e tij.

- O Zot. Unë kërkoj të shfajësohem te Ti, prej çdo armiku të familjes së Muhamedit, prej xhindeve, qofshin dhe prej njerëzve. - iu drejtua i moshuari Ali ibn Hysenit. - A ka falje për mua?

- Nëse pendohesh te Allahu, Ai ta pranon pendimin dhe ti je me ne.

- Unë jam penduar.



Jezidit i shkoi në vesh ndodhia e të moshuarit. Dha urdhër që i moshuari të vritet. E vranë.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Shumica e njerëzve janë skllevër të dynjasë dhe feja është një përsëritje në gjuhën e tyre. Për sa kohë që jeta e tyre e përditshme nuk dëmtohet, ata i drejtohen fesë. Por, kur vjen fatkeqësia, do të ketë pak besimtarë të vërtetë.”¹⁷

¹⁷ “Tuhuful Ukul”, f. 245.



FATKEQËSITË E ZONJËS ZEJNEB NË DITËN E ASHURES

Kur Mukhtar Eth Thekafiji (r.a) kapi një ushtar që kishte marrë pjesë në vrasjen e zotërisë së dëshmorëve, Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), e pyeti: “Cila ishte detyra jote në Kerbela?”

- Unë godisja fëmijët në fytyrë, - iu përgjigj i mallkuari.
- E pashë Rukijen (vajza e Imam Hysenit) te hyrja e çadrës dhe e godita atë në fytyrë. Kështu veprova me të gjithë fëmijët e Hysenit. Mirëpo dy fëmijë u larguan nga unë. Unë i ndoqa ata të dy dhe nga larg pashë një grua, e cila qëndronte në këmbë dhe ata dy fëmijë e kishin kapur nga rroba e saj. Kur i tërhiqja, për t'i shkëputur nga rroba e saj, fëmijët thoshin: “O halla Zejneb!”

Në ato momente, Mukhtarit i rridhnin lotët nga sytë.

- Më thuaj, çfarë bëre ti, kur fëmijët nuk po e lëshonin rrobën e saj? – pyeti i përlotur Mukhtari.



- Kur nuk arrita t'i tërhiqja fëmijët, mora kamxhikun tim dhe fillova t'i gjuaj asaj gruaje në kokë e te shpatullat, - foli ushtari.

Paqja qoftë mbi ty o heroina e Kerbelasë, o zonja e madhe Zejneb!



I PËRJETSHËM DO TË QËNDROJË KUJTIMI I IMAM HYSENIT (*Paqja qoftë mbi të!*)

Ndodhia e Kerbelasë ka qenë, është dhe do të mbetet ndodhia më e hidhur dhe më pikëlluese që ka njohur historia. Ajo nuk ishte si luftërat e njohura.

Ajo ishte masakër e përgjakshme për familjen e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), e cila përfshiu të mëdhenj e të vegjël. Një ushtri e madhe, injorante, zemërgur, e padrejtë dhe tirane i rrethoi ata në Kerbela. Ua ndaluan të ngrënit dhe të pirët për disa ditë me radhë.

Kur familja e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), e cila përfaqësohej nga Imam Hyseni, u rraskapit nga uria dhe etja, këta zemërgurë hodhën shigjeta, hodhën gur, goditën me shpatë e me shtiza këdo që u dilte para nga familja e pastër e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Kur u vranë të gjithë, ua prenë kokat dhe ua copëtuan trupat me patkonjtë e kuajve, sa në bark e sa në kurriz. Dogjën çadrat,

vodhën dhe grabitën sendet e tyre dhe gratë dhe vajzat e familjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i morën robëresha.

A nuk duhet të hidhërohet çdo ndjekës i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe çdo i dashur i tij nga kjo masakër? Ai që thotë e dua Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe zbatoj sunetin e tij, nuk duhet ta harrojë dhe as nuk duhet ta neglizhojë ndodhinë e Kerbelasë. Ai duhet ta kujtojë gjithmonë atë, sepse me kujtimin e Kerbelasë ai kujton Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). A nuk përpiqemi ne, myslimanët, për të fituar Xhenetin? A nuk është Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) zotëria i të rinjve të banorëve të Xhenetit? Atëherë, a nuk duhet të turpërohem para tij, nesër, në Xhenet?

S'ka dyshim se Hyseni, jo vetëm në mesin e ndjekësve të tij, por edhe në mesin e atyre që ia njohin qëllimet dhe synimet, nuk është thjesht një emër, por është simbol i heroizmit, i humanizmit, i shpresës, i fesë dhe i Sheriatit, simbol i sakrificës në rrugën e të vërtetës dhe të drejtësisë. A nuk ishte i tillë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*)? Sigurisht që po. Për këtë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Hyseni është prej meje dhe unë jam prej Hysenit."

Ndërsa Jezidi ishte simboli i shkatërrimit, i devijimit, i shtypjes, i përbaltjes, mbartës i moraleve të këqija. Aty ku gjendej shkatërrimi, gjendja kaotike, përdhosja e shenjtërive, gjakderdhja e të pafajshmëve, padrejtësia, shkelja e të drejtave, aty ishte emri i Jezidit dhe bëmat e tij. Aty ku gjendej sinqeriteti, palëkundshmëria, trimëria, morali i mirë, ndershmëria, besimi dhe devotshmëria, aty ishte emri i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Këto nuk janë deklaratat individuale, por janë të vërteta që gjenden në literaturat islame. Ringjallja e trimërisë dhe e sakrificës së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) është ringjallje e të vërtetës, e mirësisë dhe e lirisë. Ringjallja e Ashures së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) është ngritja e zërit përballë sunduesit të padrejtë dhe përkrahësve të tij. Është britmë për çdo shpërdorues të mirësive të vendit dhe të popullit. Është britmë për çdo sundimtar që mbart cilësitë e Jezidit.

I biri i Muavias donte të zhdukte Ehli Bejtin dhe të shuante dritën e Allahut. Ai dëshironte që fjala e keqe, padrejtësia dhe tirania të qëndronin më lart se fjala e mirë dhe drejtësia. Ai hamendësoi se do të triumfonte me vrasjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Por, triumfi i tij ishte vetëm një mirazh afatshkurtër. Shumë shpejt, pas ndodhisë së Kerbelasë, u rrëzua dinastia emevite, së bashku me bëmat e saj dhe mbeti Kerbelaja dhe Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*). Ata do të qëndrojnë deri në fundin e kësaj jete.



Pra, kur shi'itët e nderojnë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), e nderojnë se ai ishte nxitësi për liri e pavarësi. Ishte mësuesi i kryengritësve për drejtësi dhe barazi. Ata nuk adhurojnë individin. Ata i quajnë të shenjta parimet humane, morale dhe fetare. Ata janë myslimanë dhe zbatues të Kur'anit të Shenjtë dhe të Sunetit të bekuar të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) përfaqëson parimet e gjyshit të tij, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), për të cilat, ai, së bashku me familjen dhe shokët e tij besnikë, u martirizuan në fushën e Kerbelasë.

Mosinteresimi për revolucionin dhe kryengritjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), për ndodhinë e Ashures dhe për masakrën e Kerbelasë e ka burimin te mosnjohja e shkaqeve të tyre.

Është e vështirë që në këta pak rreshta të sqarohen shkaqet e këtij revolucioni, i cili ka depërtuar në thellësi të kohës dhe vazhdon të përçojë energji e forcë në zemrat dhe shpirtrat e të përmalluarve për liri e drejtësi. Pa dyshim se ai është revolucioni që shpëtoi mesazhin islam prej devijimit dhe humbjes, si pasojë e qejfeve dhe tekave të udhëheqësve të shthurur emevit. Prej shkaqeve më të rëndësishme të revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte shthurja, devijimi, padrejtësia, terrori i udhëheqësit dhe i

pushtetit emevit mbi myslimanët. Qëllimi i emevitëve ishte që ta bënin Islamin e pastër, shërbyes të interesave të tyre djallëzore dhe të lakmive të tyre të ulëta.

Muavia thoshte: “Pasuritë janë të Allahut dhe unë jam mëkëmbësi i Allahut. Ato që marr, janë të miat dhe ato që jap, janë bamirësi dhe bujari e imja”.

Në një thënie tjetër, Muavia i thotë Jezidit: “Cili është fëmija më i pabindur dhe më mëkatar se sa ti?! Ti e di mirë që unë, për përparësinë tënde, i quajta të gjithë njerëzit fajtorë. I zbrita ata prej vendit të tyre të lartë, për të të caktuar ty prijës dhe të emërova ty imam mbi sahabët e Profetit të Allahut. Tek ata gjendet ai që ti e njeh, Hyseni dhe mashtrova prej tyre ata që ti i njeh”.¹⁸

Qëllimi i revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte zhdukja e padrejtësisë dhe vendosja e drejtësisë. Allahu i Madhëruar thotë në Kur’anin e Shenjtë: **“Dhe mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t’ju përcëllojë Zjarri. Ju nuk do të keni mbrojtës përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni.”**¹⁹

Dhe erdhën të padrejtët dhe thanë: Anoni nga ata që bëjnë padrejtësi, se do të hyni në Xhenet! Me këtë parullë ata donin shkatërrimin e Islamit. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte për qëllim rikthimin e Islamit, ashtu siç e solli

¹⁸ “El Imametue Sijasetu”, vëll. 1, f. 167.

¹⁹ Sure “Hud”, ajeti 113.

gjyshi i tij, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ne e dimë se Allahu është mbrojtës i fesë së Tij. Mirëpo edhe ne, si myslimanë, kemi detyra ndaj kësaj feje të pastër. Njëra prej këtyre detyrave është mbrojtja e saj prej mendimeve dhe prej duarve të keqdashëve. Kjo arrihet nëpërmjet të urdhëruarit në të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është shkolla e drejtësisë islame. Për këtë, Kerbelaja është për të gjithë njerëzit dhe për mbarë popujt në rruzullin e tokës, sepse Islami është fe mbarëbotërore. Me ripërtëritjen e kujtimit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të ndodhisë së Kerbelasë ripërtërihet liria e vërtetë shpirtërore në brendinë e njerëzve.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha ushtrisë së Hur ibn Jezijd Er Rijahit, i cili shpejtoi në rrethimin e tij: “O njerëz! I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: ‘Cilido prej jush që sheh një udhëheqës të shthurur, që lejon të ndaluarat e Allahut, thyen besën që i ka dhënë Allahut, nuk vepron sipas synetit të të Dërguarit të Allahut, sillet me robtë e Allahut me mëkat e armiqtësi dhe nuk e ndryshon atë me fjalë apo me vepra, është e drejta e Allahut që atë njeri ta fusë në Xhehenem’.

S'ka dyshim se ata iu bindën shejtanit dhe e braktisën bindjen ndaj Allahut. Ata përhapën shkatërrimin, prishën kufijtë e caktuar nga Allahu, luftojnë për plaçkë lufte, e lejuan atë që ka ndaluar Allahu dhe ndaluan atë që ka lejuar Allahu. E unë e meritoj më shumë se çdo tjetër udhëheqjen, që të bëj ndryshimin. Mua më erdhën shkresat tuaja dhe të dërguarit tuaj më njoftuan për besën që më keni dhënë, se ju nuk do të më dorëzoni e as do të më poshtëroni. Nëse e plotësoni besën tuaj ndaj meje, jeni të udhëzuar, sepse unë jam Hyseni, i biri i Aliut dhe i Fatimes, që ishte e bija e të Dërguarit të Allahut. Ne jemi një. Familja ime është me familjet tuaja. Unë jam shembull për ju".²⁰

Pra, me këto fjalë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) sqaron gjendjen e dinastisë emevite në atë kohë dhe se ndryshimi dhe reformimi ishte një domosdoshmëri dhe përgjegjësi e të gjithë myslimanëve dhe jo vetëm e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), mbartësit të flamurit të Mesazhit të pastër islam.

Allahu na bëftë prej atyre që përpiqen dhe sakrifikojnë në rrugën e fesë, të paqes, të dashurisë, të vëllazërisë dhe të unitetit!

²⁰ "Tarijku Tabari", vëll. 4, f. 304; "El Kamilu fi Tarijkh", vëll. 3, f. 280.



IMAM HYSENI (*Paqja qoftë mbi të!*), SIMBOLI I UNITETIT

Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîjm!

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Hyseni është prej meje dhe unë jam prej Hysenit. Allahu e do atë që e do Hysenin dhe ai është nip prej nipave.”.

Ky është Hyseni te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), vula e profetëve.

Ky hadith gjendet në literaturat islame, sunite dhe shi'ite. Bazuar te kjo thënie dhe në thënie të tjera të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), është detyrë e umetit islam, që ta dojë Hysenin dhe ta kujtojë tragjedinë e masakrës së Kerbelasë.

Nëse ne jemi vërtet prej ndjekësve të sunetit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), atëherë duhet të ndjekim sunetin e tij.

Të hidhërohemi për vrasjen dhe masakrimin e nipit të tij, i cili dha gjithçka në rrugën e mbrojtjes së Islamit. Nuk duhet të jemi prej ndjekësve të sunetit të dinastisë emevite, e cila e shndërroi Ditën e Ashures në ditë feste e gëzimi, duke uruar njëri-tjetrin dhe e quajtën si triumf për gjyshërit e tyre që u vranë në Luftën e Bedrit nga dora e ushtrisë myslimane, nën udhëheqjen e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Është fatkeqësi të dëgjosh thëniet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për pozitën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe se ai (Profeti) është hidhëruar për vrasjen e tij, kur e lajmëroi Xhebraili (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të mos e zbatosh sunetin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ligjëruesit flasin për agjërimin e kësaj dite dhe për mirësitë e saj. Gjithashtu, edhe nëpër rrjete të ndryshme sociale predikohet veçse agjërimi në ditën e Ashures. Aq shumë i mëshohet agjërimin të Ashures, sa që mund të mendohet se agjërimi në këtë ditë është më i mirë se agjërimi në muajin e Ramazanit.

Ndërsa masakra e Kerbelasë, në të cilën u martirizua nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe imami i myslimanëve, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), përmendet shumë pak, ose në disa raste, përmendet kalimthi.

Bazuar në thëniet e Profetit të Islamit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) rreth Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) themi se ai u përket të gjithë myslimanëve. Ai nuk është pronë e asnjë medh'hebi apo tarikati. Tragjedia e tij përfshin të gjithë myslimanët.

Mos vallë jemi të përfshirë në thënien e Allahut: **“A i besoni një pjese të librit dhe mohoni pjesën tjetër?”** (Larg qoftë!)

Të gjithë ne dëshirojmë të jemi prej banorëve të Xhenetit.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Hasani dhe Hyseni janë zotërinjtë e të rinjve të banorëve të Xhenetit”*. Vallë, a jemi përgatitur, që të takohemi me zotërinë e të rinjve të banorëve të Xhenetit, Imam Hysenin?

Kushdo që e studion me maturi dhe me gjakftohtësi ndodhinë e dhimbshme të Kerbelasë, do të mësojë, se:

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është simbol i bashkimit;

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është simbol i vëllazërimit;

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është simbol i humanizmit;

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është simbol i unitetit.

Paqja qoftë mbi Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), mbi fëmijët e tij dhe mbi shokët e tij!

PSE NDODHI REVOLUCIONI NË KOHËN E IMAM HYSENIT (*Paqja qoftë mbi të*)?

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte i pari që e bëri këtë revolucion dhe askush para tij nuk e bëri këtë. Kjo sepse në kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në kohën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk ekzistonte as terreni dhe as kushtet. Edhe pse kishte shmangie apo largim në disa çështje në kohën e Imam Aliut, jo vetëm terreni që nuk ishte i përshtatshëm, por nuk ishte e pranishme as nevoja për revolucion. Për sa i përket kohës së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ekzistonin të dy faktorët, si terreni, ashtu edhe kërkesa, të cilat janë baza e revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Islami, në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), u përball me shtrembërime. Koha ishte e përshtatshme dhe terreni ishte i përgatitur, kështu që ishte e nevojshme që Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) të bënte Revolucion për të mbrojtur Islamin origjinal muhamedan.

Personi që mori pushtetin apo më mirë të themi, personi që iu dha pushteti, me padrejtësi, pas Muavias, Jezidi, nuk interesohej për çështjet e Islamit. Ai ishte i zhytur në alkool, në shturje dhe tallte Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Jo vetëm kaq, po tallte Kur'anin, duke recituar poezi që ishin në kundërshtim me Kur'anin.

Ai njeri që sulmon e kundërshton hapur Islamin dhe dëshiron ta fshijë emrin e Islamit dhe nuk e do atë, është si uji i qelbur, që prish ujin rreth tij. I tillë është edhe sundimtari i shturur dhe i devijuar.

Kushdo që zë një pozitë dhe post të lartë në shoqërinë islame, nëse nuk është besimtar, dëmi dhe shkatërrimi i tij është më i madh, sepse, kur ai, në krye të pushtetit, shturet, shturja e tij do të përhapet dhe do të mbulojë gjithë tokën. Gjithashtu, kur ai është punëmirë, sigurisht mirësia do të përhapet në çdo vend.

Një njeri i devijuar e i shturur si Jezidi, duke përdorur metodat djallëzore, u bë udhëheqës i myslimanëve, pas Muavias dhe u bë zëvendës i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). A ka të keqe më të madhe se kjo?! Përderisa çështja është e tillë, a do të thotë kjo se ka rrezik? A nuk duhet të kundërshtohet e të ndalet e keqja? Nuk ka kuptim që personi i devijuar, në krye të pushtetit, i cili simbolizon të

keqen më të madhe, të mos përballet me kundërshtarët dhe të mos marrë goditjen e duhur.

Kur thuhet se koha e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte e përshtatshme për kryengritje, kjo do të thotë se rrethanat, në shoqërinë islame, ishin të përshtatshme që Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) t'ua përcillte thirrjen e tij për reformim e ndreqje njerëzve të tij. Sigurisht që kjo thirrje është e vazhdueshme.

Nëse Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) do ta dëshironte revolucionin në kohën e Muavias, thirrja e tij do të ishte varrosur, sepse rregulli qeverisës në kohën e Muavias dhe politikat e tij ishin të tilla që njerëzit nuk mund ta dëgjonin të vërtetën. Prandaj, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk tha asgjë gjatë dhjetë viteve që ishte imam në kohën e Muavias. Ai nuk bëri asgjë dhe nuk bëri kryengritje, sepse rrethanat nuk ishin të favorshme.

Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte para Imam Hysenit dhe nuk u ngrit, sepse, gjithashtu, rrethanat nuk ishin të përshtatshme. Jo se Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ishte i aftë për këtë, sepse nuk ka dallim mes Imam Hasanit dhe Imam Hysenit, as ndërmjet Imam Hysenit dhe Imam Sexhadit, as ndërmjet Imam Hysenit dhe Imam Ali En Nekijit, ose Imam Hasan El Askarijit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Natyrisht, pozita e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili e kreu këtë xhihad, është më e lartë se ata që nuk e kanë

kryer, por imamët janë të barabartë në pozitën e Imamatit (udhëheqjes). Nëse kjo çështje do të ndodhte në kohën e ndonjë imami, ai imam do të ishte ngritur dhe do ta kishte arritur atë pozitë.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u përball me një devijim të paparë dhe rrethanat ishin të përshtatshme, ndaj ishte e pashmangshme që ai ta përmbushë detyrën e kryengritjes kundër devijimit dhe nuk kishte asnjë justifikim për mos kryerjen e kësaj detyre.



SQARIM PËR AGJËRIMIN E DITËS SË ASHURES²¹

“Vërtet, muaji shtesë është vetëm shtesë në mosbesim...”²²

Viti i myslimanëve, sipas kalendarit, fillon me vitin e emigrimit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga Meka e bekuar për në Medinen e ndritur. Historia e Hixhrit, parimisht, mbështetet në rrotullimin e hënës. Për këtë, viti i Hixhri është 11 ditë më pak se sa viti gregorian.

Gjatë vitit Hixhri ka shumë ngjarje fetare, si: Ramazani, Fitër Bajrami, Haxhi, Kurban Bajrami. Këto ngjarje nuk vijnë në një kohë të njëjtë, veçse pas tridhjetë e tre viteve, periudhë në të cilën plotësohet rrotullimi hënor. Për këtë, Ramazani vjen në verë, vjen edhe në dimër. Po ashtu edhe Haxhi.

²¹ Artikulli është shkruar nga shkrimtari saudit Nexhib Jemanij dhe është botuar në gazetën “Akadh”, në Arabinë Saudite, më 09.08.2021.

²² Sure “Et Teube”, ajeti 37.



Jehuditët thonë se kalendari i tyre fillon me fillimin e krijimit. Ata kanë njëzet (20) festa fetare, prej tyre: festa e faljes (ijdul gufran), festa e heshtjes së përmendjes së viteve të çoroditjes së tyre nëpër tokë, agjërimi me rastin e përmendjes së tyre të detit (dhikra bijsakh), nga data 15 e deri me 21 prill, që bie me muajt hënorë me muajin Ramazan ose muajin Sheval apo me muaj të tjerë. Në këto ditë ata nuk përdorin brumërat me maja. Pra, jehuditët kanë kalendarin e tyre dhe ritualet e tyre të posaçme. Nuk gjendet asnjë tekst në shkrimet e tyre, që në këtë ditë (Ashure) agjërohet. Ata veprojnë me shtimin e muajve, të cilin e ka ndaluar Allahu, duke shtuar gjashtë muaj në çdo nëntëmbëdhjetë (19) vjet. E si është e mundur që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ta pranojë saktësinë e kalendarit jehudi (hebre)?

Ne e presim muajin Muharrem me agjërimin e ditës së dhjetë (Ashures), bazuar në hadithin se, kur i Dërguari Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mbërriti në Medine, pa që jehuditët ishin agjërueshëm atë ditë. Ai tha: “Çfarë është kjo?”

Jehuditët thanë se kjo ditë është dita në të cilën shpëtuan bijtë e Izraelit nga armiku i tyre, Faraoni dhe Musai e agjëroi atë ditë. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Unë jam më parësor për Musain dhe më i merituari për agjërimin e kësaj dite se sa ju”.

Ai i urdhëroi njerëzit të agjërojnë atë ditë.

Ky agjërim bazohet edhe në ardhjen e haditheve të tjera, në forma të ndryshme, madje në kundërshtim me njëri-tjetrin për kohën dhe vendin. Ndërkohë që parimi në adhurime qëndron në thënien e Allahut, në suren “Esh Shura”, ajeti 21:

﴿أَمْ لَهُمْ شُرَكَاءُ سَرَعُوا لَهُمْ مِنَ الدِّينِ مَا لَمْ يَأْذَنْ بِهِ اللَّهُ﴾

“A kanë ata idhuj, të cilët u kanë caktuar një fe që nuk e ka lejuar Allahu?!...”

Vallë, a ka ligj, dispozitë nga Allahu për këtë agjërim?

Thonë se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) pa jehuditët që agjëronin këtë ditë, ai agjëroi dhe i urdhëroi njerëzit ta agjërojnë atë ditë. Vallë, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndjek jehuditët për çështjet e adhurimit? Kurrë. Sepse adhurimet nuk janë veçse nga Allahu. Asnjë intelektual nuk e pranon që Profeti i këtij umeti ndjek sheriatin jehudi, të cilët e devijuan sheriatin e Musait.

Në këtë thënie ka përplasje të qartë, me thënien e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që legjislacioni fetar (et teshri’u) nuk është veçse nga Allahu. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i kundërshtonte jehuditët,

duke thënë: “Kundërshtojini jehuditët dhe mexhusët”. Pra, në këto fjalë, ai i ndalon njerëzit (myslimanët) të agjëronin ditën e Ashures (dita e dhjetë e muajit Muharrem), për të kundërshtuar jehuditët e jo t’i urdhërojë të tjerët, që t’i pasojnë ata.

Gjithashtu, edhe thënia e tyre se, kur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mbërriti në Medine, pa jehuditët që agjëronin Ashuren, ka problem të madh, sepse siç e përmend Ibn Haxheri, në “El Fet’h El Barij”, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mbërriti në Medine në muajin Rabiul Evvel.

Pra, si është e mundur që ai i pa ata (jehuditët) të agjëronin Ditën e Ashures? Ai nuk kishte dijeni për agjërimin e tyre, vetëm në vitin e dytë Hixhri, atëherë për myslimanët nuk kishte mundësi tjetër veçse të agjëronin në vitin e tretë Hixhri. Edhe ky supozim nuk është i drejtë, sepse agjërimi i Ramazanit u bë detyrim në vitin e dytë Hixhri. Me detyrimin e Ramazanit bie detyrimi i Ditës së Ashures, madje edhe nga e lejuara apo e pëlqyera. Këto kundërshti e bëjnë të detyruar mosveprimin e asnjë hadithi rreth këtij agjërimi.

Prej kundërshtive, gjithashtu, është se kurejshët e agjëronin Ashuren në kohën para Islamit (xhahilijetit) dhe i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) agjëronte më ta. A mundet njeri të pranojë se

Profeti ynë i pagabueshëm, para ardhjes së kurorës së profetësisë, të pasonte politeistët, paganët në adhurim? Siç është e njohur në transmetime të sakta, të ardhura nga Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ai ishte shkëputur plotësisht nga ritet dhe adhurimet e paganëve dhe qëndronte në shpellën Hira. Më pas, plasi debati se ai agjëronte me paganët, duke ditur arsyen e atij agjërimi, që është shpëtimi i bijve të Izraelit nga Faraoni. A mund të pranohet thënia se, kur ai shkoi në Medine, pyeti jehuditët rreth agjërimin të kësaj dite?

As kurejshtët e as i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), para profetësisë, nuk kanë pasur lajme të detajuara rreth Musait, rreth Isait dhe për askënd nga popujt e mëparshëm. Këtë e dëshmon thënia e Allahut të Madhëruar, në suren “Kasas”, ajeti 44:

﴿وَمَا كُنْتَ بِجَانِبِ الْعَرَبِ إِذْ قَضَيْنَا إِلَىٰ مُوسَى الْأَمْرَ وَمَا كُنْتَ مِنَ الشَّاهِدِينَ﴾

“Ti (o Muhamed) nuk ke qenë i pranishëm në anën perëndimore (të Turit), kur Ne ia besuam Musait misionin (Profecinë) dhe as nuk ke qenë dëshmitar i kësaj ngjarjeje”.

Në librin “Kenzul Ummal” thuhet se kjo ditë nuk ka qenë dita e dhjetë e muajit Muharrem, por ka qenë dita e nëntë, sipas thënies së Ibn Abasit: “Kur të shohësh hënën e Muharremit, atëherë numëro dhe ditën e nëntë agjëroje”. Në këtë thënie ka shumë paqartësi. Madje Ibn Haxheri në librin

“Fet’hul Barij” përmend se banorët e Medines e përbuznin agjërimin e kësaj dite. Gjithashtu, përmend kundërshtimin e Muavias për këtë veprim të tyre.

Ibn Haxheri ka transmetuar nga Zejd ibn Thabi se Dita e Ashures nuk është ajo ditë për të cilën flasin njerëzit, por ishte dita e mbulimit të Qabes. Në këtë ditë kurejshët agjëronin. Kjo ditë ndryshon nga viti në vit dhe kurrë nuk është bashkuar kalendari hebre me kalendarin Hixhri. Jehuditët i llogarisnin festat e tyre me vitin diellor (gregorian). Kështu që, mospërputhja e thënieve dhe paqartësia në hadithe e bën të detyrueshëm ndalimin e veprimit, siç është e njohur në shkencën e hadithit.

Agjërimi është prej adhurimeve të mrekullueshme e të bukura. Por atë nuk duhet ta lidhim me ngjarje e histori të pabaza në Sheriatin e Allahut, sepse adhurimet nuk bazohen te tekat e te oreksi i dikujt, por bazohen te ndjekja e Atij që i ka caktuar ato adhurime.



PËRKUJTIMI I ASHURES SË DHIMBSHME DHE RINGJALLJA E SAJ ËSHTË NJË RITUAL ISLAM

Zimbajtja për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk duhet të konsiderohet si një ritual i posaçëm për pasuesit dhe dashamirësit e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), por të gjithë myslimanët duhet të organizojnë tubime për të përmendur Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ndodhinë e Kerbelasë.

Kushdo që e lexon me qetësi, arsytim e përqendrim historinë islame, larg fanatizmit verbues, do të shohë se armiku i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ka praktikuar armiqësi ndaj sunive më shumë se sa ndaj pasuesve të Ehli Bejtit (shí'itëve). Jezidi ka vrarë më shumë suni se sa shí'itë.

Në thelb, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk luftoi në betejën e Kerbelasë se është çështje shí'ite. Armiku i tij, Jezidi, ishte më shumë armik i sunive, se sa armik i shí'itëve, pasi ai, në fillim vrau suni para se të vriste shí'itë. Nëse me shí'itë nënkuptojmë ata që besojnë në udhëheqjen e Ali ibn ebu Talibit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e shohin atë si zëvendës

të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), atëherë njerëz të tillë ishin shumë pak në atë kohë dhe shumë prej tyre ranë dëshmor në betejën e Kerbelasë.

Pse Jezidi e sulmoi Medinen dhe bëri krime në ndodhinë El Hurretu, e cila ka ndodhur në vitin 63 Hixhri dhe e lau Medinen me gjakun e sahabëve?! Tiranët e Jezidit asgjësuan sunitë dhe jo shi'itët, në masakrën e El Hurratu.

Në betejën e El Hurratu, xhelatët e Jezidit kryen vrasje të tmerrshme në Medine. Nëse duam të flasim me gjuhën e sotme, duhet të themi se ata i shfarosën sunitë, pra, të njëjtët njerëz që nuk e përkrahën Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Në ndodhinë e El Hurratu, tiranët e Jezidit ua morën banorëve të Medines pasuritë, jetën dhe nderin e tyre për gjatë tri ditëve, njësoj siç veprojnë sot heretikët (tekfiristët).

Nëse e shohim Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) të revoltuar kundër Jezidit, kjo është për shkak se e vërteta e Jezidit ishte ajo që e përshkruan një poet në poezinë e tij të njohur: "Hashimi (Profeti Muhamed) luajti me pushtetin, kështu që as lajmi nuk solli e shpallje nuk ka zbritur".²³

²³ "El Ihtixhaxhu", vëll. 2, f. 307.

Pra, pas kësaj cili mysliman i arsyeshëm suni mund t'i pranojë fjalë të tilla nga Jezidi dhe ta konsiderojë atë mysliman?!

Çështja e Kerbelasë nuk është çështje shi'ite/sunite. Nëse Jezidi ishte armik i Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ai u ka bërë më shumë dëm sunive se sa shi'iteve.

Nëse xhelatët e Jezidit e vranë Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) në Kerbela, ata xhelatë të Jezidit kryen më shumë krime në Medine ndaj myslimanëve. Dua të them se, nëse krahasojmë llojin e krimeve, do të gjejmë se krimet e tyre në Medine ishin më të shëmtuara se ato krime që Omar ibn Sadi dhe ushtarët e tij kryen në Kerbela.

Prandaj, mendohuni thellë, o pronarë të arsyes!

Allahu i Madhëruar, në suren “El Hadid”, ajeti 16, thotë:

هُرَّأَلَمْ يُأْنِ لِلَّذِينَ ءَامَنُوا أَنْ تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ اللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ الْحَقِّ وَلَا يَكُونُوا كَالَّذِينَ أُوتُوا
الْكِتَابَ مِنْ قَبْلُ فَطَالَ عَلَيْهِمُ الْأَمَدُ فَقَسَتْ قُلُوبُهُمْ وَكَثِيرٌ مِّنْهُمْ فَاسِقُونَ ﴿١٦﴾

“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulën para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur”.



PAQARTËSI DHE SQARIME RRETH ASHURES

Studiuesi i asaj që ndodhi në ditën e dhjetë të muajit Muharrem (Ashure) e kupton shumë qartë se Dita e Ashures është një shkollë që pasuron brezat, me shumë parime të larta islame, të mishëruara në qëndrimet e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), të familjes dhe shokëve të tij. Prej atyre parimeve të larta, janë: sakrifica, nderimi, sinqeriteti, aspirata e lartë, qëndrueshmëria, flijimi i vetes dhe i gjërave të çmuara për hir të Allahut, besnikëria, vendosmëria, guximi, e të tjera parime të larta, që nuk i fshihen askujt që e studion këtë ngjarje me drejtësi e me maturi, larg fanatizmit verbues.

Për këtë arsye, gjeneratat e njëpasnjëshme të ndjekësve (shí'itëve) të Ehli Bejtit kanë përfituar nga bereqeti i kësaj shkolle të shenjtë dhe çdo vit e përtërijnë besnikërinë e tyre ndaj Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), dhe imamëve të tjerë të pastër. E bëjnë këtë, sepse prej imamëve fituan vendosmërinë për t'u përballur me sfidat bashkëkohore, që i godasin pasuesit e Ehli Bejtit (shí'itët) në mbarë botën.

Për aq sa shi'itët janë të interesuar të ringjallin tragjedinë e Kerbelasë, po ashtu interesohen armiqtë e tyre, të cilët hedhin dyshime mbi qëndrimet e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të*) dhe mbi rëndësinë e ripërtëritjes së kësaj ndodhie çdo vit. Me dyshimet e tyre të pabaza, ata synojnë goditjen pas shpine të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të*) dhe të revolucionit të tij të përjetshëm.

Kushdo që i shikon këto dyshime, zbulon se ato kanë përgjigje të shumta, që largojnë çdo dyshim në lidhje me këtë çështje. Po ashtu, shumica e këtyre dyshimeve kanë përgjigje të përgjithshme, që mund të jenë përgjigje për çdo problem të ngritur për këtë temë.

Nëse hedhësi i dyshimeve është prej ndjekësve (shi'itëve) të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të*), atëherë problemi i tij nuk ka bazë, sepse kur ai pranon që Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është i pagabueshëm, atëherë si mund të dyshojë për ndonjë veprim të tij?! Absolutisht pagabueshmëria e tij e pengon atë të gabojë.

Nëse hedhësi i dyshimeve nuk është prej ndjekësve të Imam Hysenit fituan, ne mund t'u përgjigjemi të gjitha dyshimeve të tij, si vijon:

1- Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është muxhtehid në kryengritjen e tij, prandaj do të shpërblehet për veprimin e tij. Nëse ka pasur të drejtë, atëherë do të ketë dy shpërblime e, nëse ka gabuar, sipas pikëpamjes së

joshi'iteve, atëherë Imami do të ketë një shpërblim. A nuk mendoni të njëjtën gjë edhe për shokët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) apo edhe për Muavian?

2- Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i lajmëroi myslimanët gjashtëdhjetë vjet para se Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) do të vritej në Kerbela. Transmetimet në literaturat e Ehli Sunetit, për këtë, temë janë të shumta. Prej atyre lajmeve përmendim:

a- Imam Ahmedi në veprën “El Musned” ka përcjellë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Një engjëll hyri në shtëpinë time. Nuk kishte hyrë më parë tek unë. Ai tha: ‘Ky djali yt, Hyseni, do të vritet. Nëse dëshiron, unë të tregoj pak nga dheu i vendit ku do të vritet ai’. Ai (Profeti) tha: “Ai (engjëlli) solli dheun e kuq”.

El Hajtemi në veprën “Mexhmau Ez Zeuaid”, vëllimi 9, faqe 187, ka thënë: “Ky hadith është transmetuar nga Ahmedi dhe transmetuesit e tij janë njerëz të besueshëm”.

b - Ebu Ja’la, El Bazzar, Et Taberani e shumë të tjerë kanë transmetuar nga Naxhij El Hadramij, i cili një ditë po ecte me Imam Aliun (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*). Kur arriti në Nejneua, në rrugën e tij për në Sifin, Aliu tha: “Bëj durim o Ebu Abdullah, bëj durim o Ebu Abdullah, buzë lumit Euftrat!”

-Çfarë është kjo? - e pyeta.

-Një ditë hyra te Profeti Muhamed dhe sytë e tij ishin të lotuar, - tha Imam Aliu. - Unë e pyeta se pse po qante.

-Pak më parë Xhibrili (alejhi selam) u largua nga unë dhe më tha se Hyseni do të vritet në lumin Eufrat, - foli Profeti Muhamed. - Xhibrili më pyeti, nëse dëshiroja ta nuhasja dheun ku do të vritet Hyseni. I thashë po. Ai zgjati dorën e tij dhe mori një grusht dheu dhe ma dha mua. Kështu që nuk mund të ndalja vërshimin e lotëve.

El Hajtemi në veprën “Mexhmau Ez Zeua’id”, vëllimi 9, faqe 187, ka thënë: “Ky hadith është transmetuar nga Ahmed, Ebu Ja’la, El Bazzari dhe Et Taberani. Transmetuesit e tij janë të besueshëm dhe Naxhij nuk është i vetmi që e ka transmetuar këtë hadith”.

b- Ibn Asakeri përcjell në librin “Tarijkhu Dimashk” se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) një ditë iu drejtua njerëzve dhe u tha: “Xhebraili më ka njoftuar se umeti im do ta vrasë djalin tim, Hysenin, në një vend që i thuhet Kerbun Belaun (*vuajtjeje dhe fatkeqësi*). Sigurisht, mallkimi i Allahut do të jetë mbi vrasësin dhe tradhtarin e tij deri në fund të kohës”.

Pastaj ai zbriti nga minberi dhe të gjithë të pranishmit, muhaxhirë dhe ensarë, e morën vesh se Hyseni do të vritet.



ç- Umu Seleme (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë:
“Një ditë, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte ulur në shtëpinë time.

- *Askush të mos hyjë te unë*, - urdhëroi Profeti Muhamed.

Unë po prisja. Pas pak hyri Hyseni. Unë dëgjova të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që po qante. Hodha shikimin dhe pashë Hysenin në prehrin e tij. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po ia fshinte ballin dhe po qante.

- Beto hem në Allah! Nuk e kuptova, kur hyri Hyseni, - i foli.

- *Xhibrili (alejhi selam), ishte me ne në shtëpi*, - tha Profeti Muhamed. - më pyeti për shumë gjëra.

- A e do Hysenin? - e pyeti Xhibraili Profetin Muhamed.

- *Sa bota e dua!* - iu përgjigj Profeti Muhamed.

- Umeti yt do ta vrasë atë, në një vend të quajtur Kerbela, - tha Xhibrili.

Xhibrili mori një pjesë të dheut të Kerbelasrë dhe ia tregoi Profetit Muhamed. Kur Hyseni u rrethua në vendin ku u vra, pyeti: “Si quhet kjo tokë?”



- Kerbela, - iu përgjigjën.

- Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë thënë të vërtetën: Kerbun dhe Belaun, - tha Imam Hyseni.

Në një transmetim tjetër, lexojmë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë të vërtetën, ky vend është Kerbun dhe Belaun”. Këtë e transmeton Taberani, me zinxhirë transmetimi. El Hejthemi ka thënë: “Transmetuesit e tij janë të besueshëm”.

Këto transmetime që përmendëm e të tjera si këto, janë të sakta, të besueshme, madje edhe *mutevatire*.²⁴ Ato janë përcjellë nga suni dhe shi'itë. Shumë hadithologë, në mesin e Ehli Sunetit, i kanë vërtetuar dhe i kanë memorizuar.

Pas gjithë kësaj, themi: Nëse kryengritja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte shkatërrim apo gabim, siç pretendojnë disa, atëherë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili u tha shokëve të tij se Hyseni, do të vritet në një vend të quajtur Kerbela,

²⁴ Në terminologji fjala *muteatire* do të thotë: Çdo hadith i cili transmetohet nga një grup i madh njerëzish që nga fillimi i zinxhirit të transmeimit deri në fund (pra, në çdo brez kemi një grup transmetuesish), numër i atillë që zakonisht e bën të pamundur mundësinë e rënies dakord mes tyre për të gënjer dhe për ta shpikur atë hadith.

duhet ta ndalonte Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), që të mos shkonte në Kerbela, ose t'i urdhëronte shokët e tij, që ta pengonin atë dhe të mos shkonte në Kerbela. Mirëpo, në asnjë hadith nuk gjendet urdhër ndalimi apo diçka që të ndiesh mospëlqimin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për kryengritjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Hadithi i Nexhij Hadramiut, i përmendur më lart, në të cilin Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të*), thotë: “Bëj durim o Ebu Abdullah, bëj durim o Ebu Abdullah buzë lumit Euftrat!”, është dëshmi e qartë se Prijësi i besimtarëve nuk sheh asnjë gabim apo dëm në daljen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) për në Kerbela. Përkundrazi, ai e nxit atë që ta bëjë këtë dhe e urdhëron të jetë i durueshëm ndaj fatkeqësisë dhe vrasjes që do t'i ndodhin atij.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është një nga zotërinjtë e të rinjve të banorëve të Xhenetit, siç dëshmohet nga hadithet e *muteuatire*. Një pjesë prej tyre i kanë përcjellë edhe hadithologët e Ehli Sunetit dhe janë të një mendimi se janë hadithe *muteuatire*.

Nëse Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është i tillë, atëherë si mund të akuzohet se i ka përçarë myslimanët apo ka bërë mëkat se nuk i është bindur udhëheqësit të kohës dhe u ngrit kundër tij, apo se ai kërkoi atë që nuk i takonte

dhe nuk kishte të drejtë?! Si mund të thuhet këto akuza të rreme për zotërinë e të rinjve të banorëve të Xhenetit?!

Kjo është përgjigjja e prerë kundër dyshimeve dhe problematikave që lindin në lidhje me qëndrimin e Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi të!) dhe me revolucionin e tij, i cili ishte revolucion i të drejtës kundër të padrejtës, i paqes kundër terrorit, i rrugës së drejtë kundër rrugës së devijuar.



IMAM HYSENI (*Paqja qoftë mbi të!*), KUR'ANI FOLËS

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte shumë i lidhur me Kur'anin. Ai e lexonte atë në çdo kohë e në çdo gjendje, madje edhe në udhëtim. Ai diskutonte dhe debatonte me kundërshtarët e tij me ajete Kur'ani.

Për shembull: Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u takua në rrugë me Mervan ibn Hakemin, ky i fundit donte që Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) t'i jepte besën Jezidit. Kur Imami ia zbuloi atij të këqijat e Jezidit, Mervani u zemërua nga fjalët e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i tha: “Betohem në Allah! Nuk do të ndahesh nga unë, deri sa t'ia japësh besën Jezidit. Ju familja e Ebu Turabit (Imam Aliut) e urreni dhe jeni në armiqësi me familjen e Beni Sufjanit. Ata kanë të drejtë t'ju urrejnë juve”.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha: “Largohu nga unë, sepse ti je i papastër dhe unë jam prej familjes së pastër. Allahu ka zbritur për ne ajetin:

﴿إِنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيُذْهِبَ عَنْكُمُ الرِّجْسَ أَهْلَ الْبَيْتِ وَيُطَهِّرَكُمْ تَطْهِيرًا﴾

“O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht”.²⁵ Në ato momente Mervani uli kokën dhe nuk foli.²⁶

✚ Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) shkoi te varri i gjyshit të tij, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe qante, njësoj siç veproi babai i tij, Ali ibn ebu Talibi, kur paria kureshe e kërcënoi se do ta vriste, nëse nuk e jepte besën. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) shkoi te varri i gjyshit të tij dhe lexoi ajetin:

﴿قَالَ ابْنُ أُمِّ إِبْنِ الْقَوْمِ اسْتَضَعُّوْنِي وَكَادُوا يَفْتُلُوْنِي فَلَا تُشْمِتْ بِي الْأَعْدَاءَ وَلَا تَجْعَلْنِي مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ﴾

“O djali i nënës sime! Në të vërtetë, këta njerëz më quajtën për të dobët dhe gati më mbytën. Mos më turpëro para armiqve dhe mos më llogarit ndër të padrejtët!”²⁷

✚ Kur doli nga Medina, natën e ditës së diel, dy netët e fundit të muajit Rexheb, të vitit 60, së bashku me fëmijët e tij, me vëllezërit e tij, me fëmijët e vëllait të tij dhe me familjen e tij, përveç Muhamed ibn Hanefijehit, filloi të lexojë këtë ajet:

²⁵ Sure “El Ahzab”, ajeti 33.

²⁶ “Maktel Khauarizmij”, vëll. 1, K. 9, f. 185.

²⁷ Sure “El A'raf”, ajeti 150.



﴿فَوَخَّرَ مِنْهَا خَائِفًا يَتَرَقَّبُ قَالَ رَبِّ نَجِّنِي مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ﴾

“Musai doli prej qytetit i frikësuar, duke pritur se ç’do të ndodhte dhe tha: ‘O Zoti im, më shpëto prej popullit keqbërës!’”²⁸

✚ Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) mbërriti në Mekë, lexoi ajetin që flet për Profetin Musa (*Paqja qoftë mbi të!*):

﴿وَلَمَّا تَوَجَّهَ تَلْقَاءَ مَدْيَنَ قَالَ عَسَى رَبِّي أَنْ يَهْدِيَنِي سَوَاءَ السَّبِيلِ﴾

“Teksa drejtohej nga Medjeni, ai tha: ‘Shpresoj se Zoti im do të më tregojë rrugën e drejtë!’”²⁹

✚ Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) doli nga Meka, Amr ibn Saijdi, prijësi i Hixhaxit, e kundërshtoi Imamin dhe donte ta ndalonte nga rrugëtimi për në Irak. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj me ajetin e Kur’anit:

﴿فَقُلْ لِي عَمَلِي وَلَكُمْ عَمَلُكُمْ أَنْتُمْ بَرِيئُونَ مِمَّا أَعْمَلُ وَأَنَا بَرِيءٌ مِمَّا تَعْمَلُونَ﴾

“Ju s’jeni përgjegjës për atë që bëj unë dhe as unë s’jam përgjegjës për atë që bëni ju”³⁰.

²⁸ Sure “El Kasas”, ajeti 21.

²⁹ Sure “El Kasas”, ajeti 22.

³⁰ Sure “Junus”, ajeti 41.

✚ Kur mbërriti në vendin e quajtur Kasrur Mukatil, ai ndaloi dhe pa një vendbanim të dëmtuar, që i përkiste Ubejdullah ibn El Hurr El Xhu'fij. Imami e ftoi atë që ta përkrahte, por ai nuk pranoi. Imami iu kthye dhe i lexoi ajetin e Kur'anit:

﴿وَمَا كُنْتُمْ تُحَدِّثُوا الْمُضِلِّينَ عَصُدٌ﴾

“Unë nuk mund t’i marr si ndihmës ata, që çojnë të tjerët në humbje”.³¹

✚ Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e paralajmëroi ushtrinë emevite prej humbjes dhe fundit të keq. Kur Kajs ibn Ash’athi i kërkoi të pranonte udhëheqjen e Jezidit, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha atij dhe atyre që ishin me të:

﴿إِنِّي عُدْتُ بِرَبِّي وَرَبِّكُمْ مِنْ كُلِّ مُتَكَبِّرٍ لَا يُؤْمِنُ بِيَوْمِ الْحِسَابِ﴾

“Unë i lutem Zotit Tim dhe Zotit tuaj për të më mbrojtur prej çdo mendjemadhi, që nuk beson në Ditën e Llogarisë!”³²

Por ata nuk iu përgjigjën ftesës së Imamit, pasi lakmia ua kishte errësuar sytë dhe injoranca ua kishte mbuluar zemrat.

³¹ Sure “Kehf”, ajeti 51.

³² Sure “Gafir”, ajeti 27.

✚ Kur ishte rrugës për në Kufe, Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) i erdhi lajmi i vrasjes së ambasadorit të tij, Kajs ibn Musahhar es Sajdauj. Në ato çaste lexoi ajetin:

﴿مِنَ الْمُؤْمِنِينَ رِجَالٌ صَدَقُوا مَا عَاهَدُوا اللَّهَ عَلَيْهِ فَمِنْهُمْ مَّنْ قَضَىٰ نَحْبَهُ وَمِنْهُمْ مَّنْ يَنْتَظِرُ وَمَا بَدَّلُوا تَبْدِيلًا﴾

“Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre”.³³ Pastaj Imami e lavdëroi dhe iu lut Allahut që ta mëshironte dhe ta falte Kajs ibn Musahhar es Sajdaujin.

✚ Po të njëjtin ajet lexoi edhe kur mori lajmin e vrasjes së Muslim ibn Ausexhetut. Ai shkoi te ai së bashku me Habijb ibn Mudhahirin. Kur u afruan te Ausexhetu, Imami tha: “Allahu të mëshiroftë o Muslim!”. Pastaj lexoi ajetin:

﴿فَمِنْهُمْ مَّنْ قَضَىٰ نَحْبَهُ وَمِنْهُمْ مَّنْ يَنْتَظِرُ وَمَا بَدَّلُوا تَبْدِيلًا﴾

“Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre”.³⁴

✚ Ed Dahak ibn Abdullah el Meshrikij ka thënë: “Kur u ngrysh, Hyseni, së bashku me shokët e tij, qëndruan gjithë natën duke u falur, duke kërkuar falje, duke u përgjyruar e

³³ Sure “El Ahzab”, ajeti 23.

³⁴ Sure “El Ahzab”, ajeti 23.

duke u lutur. Kur afër nesh kalonin kalorësit e tyre për të na vëzhguar, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) lexonte ajetin:

هُرُولَا يَحْسَبَنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنَّمَا نُثَمِّلِي لَهُمْ خَيْرٌ لِّأَنفُسِهِمْ إِنَّمَا نُوثَمِّلِي لَهُمْ لِيَزِدَّادُوا إِثْمًا وَلَهُمْ عَذَابٌ

مُهِينٌ مَا كَانَ اللَّهُ لِيَذَرَ الْمُؤْمِنِينَ عَلَىٰ مَا أَنْتُمْ عَلَيْهِ حَتَّىٰ يَمِيزَ الْخَبِيثَ مِنَ الطَّيِّبِ ﴿٤٥﴾

“Le të mos mendojnë kurrsesi jobesimtarët se për ata është mirë që ua zgjasim jetën. Ne ua zgjasim jetën vetëm për t’i shtuar gjynahet; për ata ka ndëshkim poshtërues. Allahu nuk i lë besimtarët në gjendjen që ndodheni ju, por do ta ndajë të keqin prej të mirit...”³⁵

Kur një nga kalorësit e dëgjoji ajetin, tha: ‘Betohem në Zotin e Qabesë, se ne jemi të mirët dhe jemi më të dalluar nga ju!’

- Unë e njoha atë që tha këto fjalë, - tha Abdullahu.
- A e di kush është ai? – e pyeta Burejri ibn Khudejri.
- Jo, - më tha ai.
- Ai është Ebu Harb ibn es Sebij’i Abdullah ibn Shehri, - i thashë. - Ai ishte qesharak dhe i papunë.
- O i shturur! – iu drejtua Burejri atij. - Pse ty, do të të bëjë Allahu prej të mirëve?³⁶

³⁵ Sure “Ali Imran”, ajetet 178-179.

³⁶ “Tarijku Et Tabarij”, vëll. 6, K. “Ndodhitë e vitit 61 Hixhri”, f. 226.



Me sa duket, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e lexonte Kur'anin me zë të lartë, me qëllim që të ndikonte në shpirtrat e armiqve, mirëpo lakmia ua kishte mbyllur atyre dritaret e dëgjimit.

✚ Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) pa djalin e tij, Ali Akbarin, në fushën e betejës, u drejtua kah qielli dhe lexoi ajetin:

﴿إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ آدَمَ وَنُوحًا وَآلَ إِبْرَاهِيمَ وَآلَ عِمْرَانَ عَلَى الْعَالَمِينَ * ذُرِّيَّتَهُ بَعْضَهَا مِنْ بَعْضٍ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ﴾

“Allahu i zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit (e kohës së tyre). (Ata ishin) pasardhës të njëri-tjetrit. Allahu dëgjon dhe di çdo gjë”.³⁷

✚ Kur ushtria po i afrohej kampit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ai thirri t’i sjellin kalin e tij. Imami i hipi kalit dhe thërriti me zë të lartë: “O njerëz! Dëgjojeni fjalën time dhe mos u nxitoni, deri sa t’ju këshilloj për atë që keni të drejtë ndaj meje. Nëse më jepni gjysmën e të drejtës, do të jem i lumtur për këtë. Nëse nuk më jepni gjysmën, atëherë:

﴿فَعَلَى اللَّهِ تَوَكَّلْتُ فَأَجْمِعُوا أَمْرَكُمْ وَشُرَكَاءَكُمْ ثُمَّ لَا يَكُنْ أَمْرُكُمْ عَلَيْكُمْ غُمَّةً ثُمَّ اقْضُوا إِلَيَّ وَلَا تُنظِرُونِ﴾

³⁷ Sure “Ai Imran”, ajetet 33-34.

“...(dijeni se) unë jam mbështetur vetëm tek Allahu! Prandaj, bashkë me idhujt tuaj, vendosni si do të veproni dhe vendimi juaj le të mos fshihet; zbatoheni kundër meje e mos më jepni kohë”.^{38,39}

Pastaj lexoi edhe ajetin:

﴿إِنَّ وَلِيَّيَ اللَّهِ الَّذِي نَزَلَ الْكِتَابَ وَهُوَ يَتَوَلَّى الصَّالِحِينَ﴾

“Në të vërtetë, Mbrojtësi (Kujdestari) im është Allahu, i Cili ka zbritur Librin dhe kujdeset për të mirët”.⁴⁰

Gjithashtu, edhe shokët e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dëshmonin me Kur’an. Për shembull: Handhaletu ibn Es'ad esh Shebamiji ishte me Imamin, u ngrit e thirri me zë të lartë, duke lexuar ajetin:

﴿إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ مِثْلَ يَوْمِ الْأَحْزَابِ مِثْلَ دَابِ قَوْمِ نُوحٍ وَعَادٍ وَثَمُودَ وَالَّذِينَ مِنْ بَعْدِهِمْ وَمَا اللَّهُ يُرِيدُ ظُلْمًا لِلْعِبَادِ وَإِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ يَوْمَ التَّنَادِ يَوْمَ الْمُتَوَلُّونَ مُدْبِرِينَ مَا لَكُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ عَاصِمٍ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ هَادٍ﴾

“O populli im, unë druaj se do t’ju arrijë dënimi si popujve të mëparshëm, ashtu siç ka qenë për popullin e Nuhut, për fiset Ad e Themud dhe për breznitë pas tyre.

³⁸ Sure “Junus”, ajeti 71.

³⁹ “El Irshad”, vëll. 2, f. 97.

⁴⁰ Sure “El A’raf”, ajeti 196.

Allahu nuk synon padrejtësi për robtë e Vet. O populli im, unë i druhem vërtet Ditës, kur do të thërrisni njëri-tjetrin, Ditës kur, nga frika do të ikni prapa, pa pasur askënd që t’ju mbrojnë nga dënimi i Allahut. Atë që Allahu e shpie në humbje, nuk mund ta udhëzojë kush”.⁴¹

Pastaj tha: “O popull! Po vrisni Hysenin?!” Dhe lexoj ajetin:

﴿فَيُسْحِتْكُمْ بِعَذَابٍ وَقَدْ خَابَ مَنْ افْتَرَى﴾

“Ai do t’ju shkatërrojë me dënim. Do të dështojnë me siguri, ata që trillojnë gënjeshtër”.⁴²

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “O Ibn Es’ad! Allahu të mëshiroftë! Ata iu përgjigjën dënimit, kur të kundërshtuan ftesën drejt të vërtetës”.⁴³⁻⁴⁴

⁴¹ Sure “Gafir”, ajetet 30-33.

⁴² Sure “Ta Ha”, ajeti 61.

⁴³ “Tarijkhü Et Tabarij”, vëll. 6, K. “Ndodhitë e vitit 61 hixhri”, f. 240.

⁴⁴ “El Luhufu”, f. 65.



HYTBEJA E ZONJËS ZEJNEB, MOTRA E IMAM HYSENIT, NË PRANI TË JEZIDIT

Zonja e madhe Zejneb, motra e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) i ka thënë Jezidit: “Betohem në Zot, o Jezid, se çdo gjë që bëre, do të kthehet te vetja jote, sepse ti nuk preve asgjë tjetër veç lëkurës tënde dhe copëtove mishin tënd.

O Jezid! A e di se në ç'gjendje do të jesh atë ditë, kur Zoti do t'i paraqesë trupat e pastër të shehidëve tanë, që të kërkojnë hakun e vet prej vrasësit të tyre? A e di se si do të jetë gjendja jote, kur të dalësh para të Dërguarit të Zotit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që ti e derdhe lumë gjakun e të dashurve të Tij dhe shkele në dinjitetin e trashëgimtarëve të tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

O Jezid! A kujtove se ne emi pa vlerë tek Allahu dhe se ti je i nderuar tek Ai? Kjo tregon rrezikshmërinë e madhe që ke para Tij?! Ngre hundën dhe kontrollon dhembshurinë, tej mase i gëzuar, kur e sheh dynjanë të lidhur para teje dhe, kur sheh se punët të shkojnë mbarë, ndërkohë që grabit pronat dhe pushtetin tonë? Ngadalë! Ngadalë! A e harrove

fjalën e Allahut të Madhëruar: **“Le të mos mendojnë kurrsesi jobesimtarët, se për ata është mirë që ua zgjasim jetën. Ne ua zgjasim jetën vetëm për t’i shtuar gjynahet; për ata ka ndëshkim poshtërues.”**⁴⁵

O Jezid! Muhamedi është gjyshi yt apo gjyshi im? Nëse thua se është gjyshi yt, gënjen dhe mohon.

Nëse thua se është gjyshi im, përse ia vrave atij gjenezën (pasardhësit)?

O Jezid! Thur komplete, mashtro, intrigo, trillo, përpiqu me të gjitha mundësitë e tua, por, betohem në Allah, se ti kurrë nuk do ta fshish përmendjen tonë e as nuk do ta zhdukësh shpalljen tonë.

O Jezid! Pushteti të ka shkatërruar humanizmin. Ti je prej të dënuarve në Botën Tjetër! Qofsh i mallkuar! Ti po lufton fenë e të Dërguarit të Allahut. Por, dije se, edhe sikur të shfrytëzosh të gjitha mundësitë, feja jonë nuk do të zhduket, por do të mbetet e gjallë përgjithmonë. Kurse ti do të zhdukesh dhe do të fshihesh përgjithmonë.

O Jezid! Duke mohuar shenjat e Allahut dhe duke i mbajtur ata të përrulur, jeni bërë të lumtur. Recitoni vargje poetike duke përdhosur dëshmorët, fëmijët e Profetit të shenjtë, njëjtë si politeistët e Mekës, që u lumturuan dhe kënduan këngë, për dëshmorët e Betejës së Uhudit. Mos po

⁴⁵ Sure “Ali Imran”, ajeti 178.

flasim për hakmarrje ndaj Profetit të shenjtë. Po si jeni bërë si ata dhe si e keni arritur këtë fazë? Ju keni arritur në këtë fazë, sepse keni kryer shumë mëkate. Kushdo që shkel rrugën e mëkatit dhe këmbëngul në kryerjen e mëkateve, sipas ligjit të Kurnit, do t'i mohojë një ditë dhe do t'i tallë shenjat e Allahut. Si rrjedhim, do të meritojë ndëshkimin hyjnor.

O Jezid! A mendon se ne jemi bërë të përulur dhe të përçmuar për shkak të martirizimit të popullit tonë dhe robërisë tonë? Si mendon, se meqë keni bllokuar të gjitha shtigjet dhe na keni kthyer robër, Allahu i ka hequr bekimet e tij prej nesh? A mendon se duke vrarë personat, je bërë i madh dhe i respektueshëm dhe i Plotfuqishmi të shikon me hir dhe mirësi të veçantë? Për këtë arsye, ju jeni bërë të ngathët dhe arrogantë. Ju jeni krenarë, sepse keni parë që çështjet kanë marrë një kthesë në favorin tuaj. Por keni harruar atë që thotë Allahu: **“Le të mos mendojnë kursesi jobsimtarët se për ata është mirë që ua zgjasim jetën. Ne ua zgjasim jetën vetëm për t'i shtuar gjynahet; për ata ka ndëshkim poshtërues.”**⁴⁶

Atëherë zonja Zejneb i kujtoi Jezidit se në ditën e pushtimit të Mekës, që ndodhi në vitin 8 Hixhri, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) liroi të gjithë burrat dhe gratë e Mekës. Vetë Jezidi ishte një prej atyre personave. Babai i tij, Muavia, gjyshi i tij, Ebu

⁴⁶ Sure “Ali Imran”, ajeti 178.

Sufjani dhe nëna e Muavias, ishin midis atyre që u lanë të lirë në kohën e pushtimit të Mekës. Në atë ditë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), pa marrë parasysh ato që kishin bërë në të kaluarën, u tha: “Shkoni, sepse të gjithë ju jeni të lirë”.

E bija e Imam Aliut, temë të fjalës së saj, pas këtij rikujtimi, bëri pushtimin e Mekës. Midis të tjerash, tha: “O biri i të liruave! A është drejtësi, që ju t’i mbani gratë tuaja dhe skllëverit tuaj në izolim, që vajzën e pafuqishme të Profetit të shenjtë e hipni në deve dhe ua dorëzoni armiqve të tyre, në mënyrë që ata t’i shëtisin si trofe nga njëri qytet në tjetrin?!”

Pse duhet të hidhërohet Jezidi me ne dhe të na vështrojë me armiqësi. Ju thoni, se po bëj mëkat. Uroj që paraardhësit e mi, që u vranë në Bedër të ishin sot këtu. Ju godisni Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) me shkop. Ju keni derdhur gjakun e bijve të Profetit të shenjtë dhe keni fshehur yjet shkëlqyese, pasardhësit e Abdul Mutalibit, nën retë e shtypjes dhe të padrejtësisë. Megjithatë, ju do të shkoni së shpejti para Allahut. Do të takoni paraardhësit tuaj dhe do të merreni, gjithashtu, në vendin e tyre. Në atë kohë, do të dëshironit të ishit të verbër dhe memecë dhe të mos kishit thënë se ishte një ditë e gëzimit për të parët tuaj”.

Në këtë fazë, vajza e Imam Aliut iu lut Allahut: “O Zot! Përcille të drejtën tonë dhe hakmerru ndaj atyre që na kanë shtypur!” Pastaj ajo iu drejtua Jezidit: “Pasha Allahun,

ju keni hequr lëkurën tuaj dhe keni prerë mishin tuaj. Së shpejti do të shkoni para Profetit të Allahut dhe do të shihni me sytë tuaj se fëmijët e tij janë në Parajsë. Do të jetë dita, kur Allahu do t'i shpëtojë pasardhësit e Profetit të shenjtë nga gjendja e shpërndarjes dhe do t'i tubojë të gjithë në Parajsë. Ky është premtimi që Allahu ka bërë në Kur'anin e Shenjtë: **“Kurrsesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre.”**⁴⁷

O Jezid! Në ditën, kur Allahu do të jetë Gjykatësi dhe Muhamedi do të jetë kërkuesi, dhe gjymtyrët tuaja do të dëshmojnë kundër jush, babai juaj, i cili ju bëri sundimtar të myslimanëve, do të marrë dënimin e tij. Në atë ditë, do të bëhet e ditur se çfarë shpërblimi fitojnë shtypësit, pozita e të cilëve është e keqe.

O armik i Allahut dhe o bir i armikut të Allahut! Beto hem për Allah, se ju konsideroj të përulur dhe jo të përshtatshëm për postin që keni. Por çfarë duhet të bëj? Sytë tanë lotojnë, zemrat tona po digjen. Dëshmorët tanë nuk mund të vijnë në jetë për t'ju qortuar. Hyseni im është vrarë dhe partizanët e shejtanit po na çojnë te budallenjtë, në mënyrë që ata të marrin shpërblimin e tyre për fyerjen ndaj Allahut. Gjaku ynë po pikon nga duart e tyre dhe mishi ynë po bie nga goja e tyre. Trupat e shenjtë të dëshmorëve janë vendosur në gojën e ujqërve dhe të kafshëve të tjera

⁴⁷ Sure “Ali Imran”, ajeti 169.

mishngrënëse të xhunglës. Nëse keni fituar diçka sot, duke derdhur gjak, me siguri do të jeni humbës në Ditën e Gjykimit. Në atë ditë, asgjë, përveç veprave tuaja, nuk do të llogaritet. Atë ditë, ju do të mallkoni Ibn Marxhāna dhe ai do t'ju mallkojë. Në atë ditë, ju dhe ndjekësit tuaj do të grindeni me njëri-tjetrin përkrah shkallës Hyjnore të Drejtësisë. Në atë ditë, do të shihni se gjëja më e mirë që baballarët tuaj bënë për ju, ishte se ata ju mundësuan të vrisni fëmijët e Profetit të Allahut. Betohem në Allah, se nuk kam frikë nga askush, përveç Tij dhe nuk i ankohe askujt tjetër. Ju mund të përdorni përpjekjet tuaja mashtruese dhe dinake, por betohem në Allah, se turpi dhe poshtërsia që keni fituar, me mënyrën se si na keni trajtuar, nuk mund të zhduket”.

Vajza e Fatime Zehrasë e përfundoi fjalimin e saj, duke falënderuar Allahun: “Falënderoj Allahun, që e ka përmbyllur detyrën e shefave të të rinjve të Xhenetit, me mbarësi dhe falje dhe i strehoi ata në Parajsë. I lutem Allahut, që t'i lartësojë radhët e tyre dhe t'i nderojë ata me mirësinë e Tij, sepse Allahu është i Gjithëfuqishëm!”⁴⁸

⁴⁸ “Balāgatu Nisa”, Abul Fazl Ahmad bin Abi Tahir.



ZONJA ZEJNEB ISHTE ZËRI I HYSENIT

Zonja Zejneb ishte zëri i Hysenit.

Ishte gjaku i Hysenit dhe vazhdimësia e tij.

Ishte personaliteti i Hysenit.

Ishte shikimi dhe mprehtësia e Hysenit.

Ajo ishte Hyseni në trupin e një gruaje.

Zonja Zejneb është krenare, sepse ajo mori nga dituria e gjyshit të saj, të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*); guximin e mori nga babai i saj, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*); durimin e mori nga nëna e saj, Fatime Zehraja; vetëpërmbytjen e mori nga vëllai i saj, Hasani; xhihadin e mori nga vëllai i saj, Hyseni. Kështu që ajo u bë pikëbashkimi i virtyteve të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Zonja Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte shpata folëse e Hysenit. Ky është një tjetër virtyt prej virtyteve të saj.

Ata e vranë Hysenin për t'ia mbyllur gojën. Mirëpo Zejnebi foli me gjuhën e tij. Ata nuk mundën t'ia mbyllnin gojën kësaj Zonje madhështore. Ashtu si Fatime Zehraja, e cila ishte nëna e babait të saj, në Medine, Zejnebi ishte nëna e vëllait të saj, Hysenit, në Kerbela.

Kur Hyseni po merrte frymën e fundit, i dëshpëruar nga ata që e luftuan, zemra e tij ishte e qetë, sepse motra e tij, Zejnebi, do ta mbante flamurin e tij dhe do ta vendoste kudo, në mënyrë që të mos mbetej asnjë njeri i vetëm në faqen e dheut pa dëgjuar emrin e tij. Të mos mbetej asnjë grua pa e treguar historinë e Ashures e asnjë fëmijë të mos mbetej pa e fiksuar emrin e Kerbelasë.

Kur Zejnebi i tha me zë të lartë Jezidit: “Unë e nënçmoj fatin tënd dhe e lartësoj kritikën tënde”, ajo jo vetëm që e nënvlerësoi Jezidin, por po lajmëronte edhe fundin e perandorisë së keqe, e përfaqësuar nga ai i lig.

Ishte e caktuar që ajo të udhëhiqte pjesëtarët e familjes profetike, pas vrasjes së vëllait të saj, Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo duroi dhe e mbajti mbi supë përgjegjësinë e saj, për t'u thënë njerëzve se barra e mesazhit është e rëndë dhe nuk lejohet neglizhenca në bartjen e tij.

Sikur Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*) të ishte në Kerbela, do të kishte bërë atë që bëri Zejnebi. Sikur Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) të ishte në Ditën e Ashures, do të kishte bërë atë që bëri Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

A priste ndokush që fëmijët e Fatimes dhe të Aliut (*Paqja qoftë mbi ta!*) të bënin diçka tjetër përveç asaj që bënë baballarët e tyre? E ajo ishte mbrojtja dhe përhapja e mesazhit të pastër islam.

Nëse Zejnebi do të ishte burrë, ajo do të ishte Hyseni.

Nëse Hyseni do të ishte grua, ai do të ishte Zejnebi.

Ata të dy janë një person në dy forma të ndryshme.

Të humbur e të zhgënjyer janë ata që nuk e njohin dinjitetin e gruas dhe ndërkohë shohin se si Allahu e nderoi Zejnebin, me dituri, njohuri, guxim, elokuencë dhe me gjithçka që gjendet në fjalorin e virtyteve.

Tri gra madhështore i qëndruan në krah tre burrave të mëdhenj dhe mbajtën mbi supe barrën e fesë së fundit dhe mesazhin e vulës së profecive: Hatixheja me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Fatimja me Aliun (*Paqja qoftë mbi ata të dy!*), Zejnebi me Hysenin (*Paqja qoftë mbi ata të dy!*).

Zejnebi ishte gruaja që duhej të ishte, në pozicionin që duhet të ishte dhe në formën që duhet të ishte.

Ishte dëshira dhe drejtësia e Allahut, që në krah të një burri të madh, si Hyseni, të ishte një grua e madhe, si Zejnebi.



Sa më shumë shtoheshin faktorët e dëshpërimit dhe grumbulloheshin tek ajo, aq më shumë shtoheshin shpresa e saj te Allahu. Kur Jezidi e ofendoi Zejnebin: “Si e pe veprimin e Allahut me ty?”, ajo iu përgjigj: “Unë kam parë vetëm bukuri”. Zemra e saj plot besim, nuk sheh veçse bukuri në ato që bën Allahu.

Zejnebi është argumenti i Allahut për të gjitha gratë e tokës. Gratë të mos heshtin ndaj tiranisë së shtypësit, as ndaj zemërimit të të shtypurve. Ato duhet të marrin përgjegjësitë e tyre para burrave, me burrat dhe pas burrave. Gruaja është një bari i pavarur për pjesëtarët e saj. Është, gjithashtu, përgjegjëse për ata.

Në Sham (Damaskun e sotëm) Zejnebi (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte e huaj dhe robinë. Ishte e prangosur dhe e privuar, por ajo nuk u mposht kurrë.

Prandaj, ajo e shtriu shtatin e saj si mal, e ngriti zërin si bubullimë dhe i bërtiti në fytyrë tiranit famëkeq, Jezidit të mallkuar, duke thënë: “Thur komplete e përpiqu. Beto hem në Allah, se ti kurrë nuk do ta fshish kujtimin tonë dhe nuk do ta vdesësh Shpalljen tonë”. Kështu, u vërtetua se gratë janë në gjendje të bëjnë atë që bëjnë burrat dhe ndonjëherë më shumë se çfarë bëjnë burrat.

Zonja e madhe Zejneb ka dëshmuar se një grua mund të sfidojë, në dashtë Allahu, një perandori të tërë dhe të kontribuojë, gjithashtu, në shkatërrimin e saj.

Merjemja, e bija e Imranit, ishte bartëse e vuajtjeve të Mesihut. Ndërsa Zejnebi, vajza e Aliut, ishte bartëse e dhimbjes së Ehli Bejtit.

Para martirizimit, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e porositi motrën e tij, zonjën Zejneb, që të mbronte gratë dhe fëmijët, pas martirizimit të tij.

Kur ushtarët e Jezidit të mallkuar sulmuan çadrat, gratë dhe fëmijët strehoheshin dhe fshiheshin pas heroinës së Kerbelasë, zonjës Zejneb, për t'u shpëtuar goditjeve të kamxhikëve dhe të shkopinjve.

Zonja e Madhe Zejneb i mbronte ata, ashtu si shpendi mbron zogjtë e tij nga egërsirat. Ajo i mbulonte gratë dhe fëmijët me trupin e saj, saqë trupi iu nxi nga goditjet e kamxhikëve e të shkopinjve.

Transmetohet se një ushtar kriminel ka thënë: “Kur po rrihja fëmijët në Kerbela, dy prej fëmijëve më shpëtuan dhe ikën me vrap. Unë i ndoqa ata. Pastaj pashë një grua që qëndronte në këmbë dhe dy fëmijët ishin kapur pas rrobës së saj dhe thërrisnin: ‘O Zejneb! O Zejneb!’

Kjo është zonja e madhe Zejneb, e lindura fisnike, nëna e të nderuarve dhe thesari i virtyteve dhe i kerameteve.

Paqja qoftë mbi heroinën e Kerbelasë, të madhen, zonjën Zejneb, e bija e Imam Aliut!

Mallkimi i Allahut qoftë mbi kriminelët!



ANA HUMANE E NDODHISË SË KERBELASË

﴿ذَلِكَ وَمَنْ يُعِظْ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِنْ تَقْوَى الْقُلُوبِ﴾

“...e kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.”⁴⁹

Me qindra e qindra vite, myslimanët në mbarë botën, veçanërisht pasuesit e Ehli Bejtit vazhdojnë të mbajnë të gjallë ndodhinë e Kerbelasë, në të cilën u vra e u masakrua nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*). Në këtë ditë u vra simboli i unitetit islam, simboli i dashurisë në zemrat e besimtarëve, i cili lëkundti ndërgjegjen e myslimanëve dhe të jomyslimanëve dhe bëri revolucionin më të madh në historinë e Islamit.

Në këtë ditë iu pre koka djalit të Fatime Zehrasë. Në këtë ditë u morën robina vajzat e Fatime Zehrasë. Në këtë ditë nuk u mëshirua as foshnja gjashtëmuajshe nga tehu i

⁴⁹ Sure “Haxhxh”, ajeti 32.

shigjetës. Në këtë ditë u sqarua se çfarë kuptimi të vërtetë ka fjala besnikëri. Në këtë ditë u plotësua dëshira dhe urtësia e Allahut për vazhdimësinë e gjenezës së pastër të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) me qëndrimin gjallë të Imam Zejnul Abidinit, i biri i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi ta*).

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u rrit dhe u edukua në shkollën e shenjtë të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e cila ishte e mbushur me dashuri dhe mëshirë jo vetëm për myslimanët, por për mbarë njerëzimin. Ai u edukua në shkollën që urdhëronte për unitet në radhët e myslimanëve.

Për këtë, në çdo vit myslimanët shi'itë mbajnë zi për dhjetë ditë me radhë, duke filluar që në fillim të muajit Muharrem. Mirëpo, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk është vetëm i shi'itëve. Ai është Imami i të gjithë myslimanëve. Ai është i biri i Imam Aliut, i biri i Fatimes dhe zotëria i të rinjve të banorëve të Xhenetit. Për këtë, është detyrë e të gjithë myslimanëve, që ta kujtojnë Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ndodhinë e Ashures.

Ndodhia e Kerbelasë dhe kryengritja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) është një kryengritje humane, me të gjitha dimensionet e saj. Është humane në shkaqet e saj, në lëvizjet e saj dhe në qëllimet e saj. Revolucioni i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte për qëllim ruajtjen e vlerave të larta morale dhe humane. Mirëpo, të shumtë janë ata njerëz që

nuk e njohin këtë anë të kryengritjes së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Themi se kryengritja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte humane, sepse bazohej te besimi në Allah, i cili dëshiron prej nesh, që të bëjmë vetëm punë të mira dhe të qëndrojmë larg të këqijave. Ai njeri që beson, është i butë, i dashur, i dhembshëm dhe kurrë nuk i nëpërkëmb të drejtat e Allahut dhe të drejtat e njerëzve (hakku llahi dhe hakku nasi).

Prej anëve humane dhe njerëzore të betejës së Kerbelasë përmendim:

1- Dhembshuria e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*)

Transmetohet se, kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte në fushën e Kerbelasë dhe po vështronte ushtrinë e Jezidit, që udhëhiqej nga Umer ibn Sa'di, filloi të qajë. Kur e pa e motra e tij, zonja e madhe Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*), i tha: “Pse qan, o vëllai im?” Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Nuk po qaj për veten time, por për atë ushtri që do të hyjë në zjarr”.

A ka humanizëm të ngjashëm me këtë? Të qash e të kesh dhembshuri për ata që kanë ardhur për të të vrarë e për të masakruar.

2- Mëshira ndaj armiqve

Është e natyrshme që njeriu të ketë mëshirë ndaj familjarëve të tij, fëmijëve bashkëshortes së tij, më të afërmve të tij, miqve dhe shokëve të tij. Kushdo që e lexon historinë e kryengritjes së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), do të gjejë se ajo përmban mëshirë. Por që të jesh i mëshirshëm ndaj armikut të tij, duhet të jesh i pajisur me vlera të larta morale e humane. Këtë nuk e bëjnë veçse ata njerëz të pastër shpirtërisht, siç janë profetët dhe pjesëtarët e familjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilët Allahu i ka pastruar nga çdo papastërti shpirtërore. I tillë ishte Imami ynë, prijësi i të gjithë myslimanëve, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në historinë e betejës së Kerbelasë përmendet kjo histori:

Kur El Hurr ibn Jezijd Err Rrihahi, së bashku me njëmijë kalorës, u takua me karvanin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte kohë dreke dhe piku i vapës. Ata ishin shumë të etur. Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) i pa ata, i erdhi keq dhe urdhëroi shokët e tij që t'u jepnin ujë. Nuk u mjaftua vetëm me këtë, ai urdhëroi që t'u jepnin edhe kuajve të tyre të pinin ujë. Me këtë veprim, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) tregoi një qëndrim madhështor human, të cilin duhet ta njohin të gjithë. Përballë këtij qëndrimi human të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) shohim qëndrimin e

ushtrisë emevite, se si veproi me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Ushtria emevite bëri një veprim të egër e antinjerëzor ndaj Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ndaj familjes së tij dhe shokëve të tij. Ata ia ndaluan atyre ujin, derisa u martirizuan të etur e me buzë të thata.

Ajo që kemi nevojë sot, është që mesazhin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ta shpërndajmë në mbarë botën, sepse mesazhi i tij është i mbushur me paqe, mirësi, mëshirë e dashuri për mbarë njerëzit.

3- Mirësia (ihsani) ndaj armikut

Prej qëndrimeve humane të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) është mirësia ndaj armikut të tij.

Njeriu human bashkëpunon me mirësi, me dashuri dhe me respekt me të gjithë, madje edhe me armiqtë dhe kundërshtarët e tij. I tillë ishte Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

Një ditë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) vizitoi Usama ibn Zejdinin, kur ishte i sëmurë, edhe pse Usama ishte në radhët e kundërshtarëve të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Kur Usama e pa Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), tha më zë të lartë:



- Ah ç'fatkeqësi!

- Cila është fatkeqësia jote, o vëllai im? - i tha Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

Pra, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) përdori fjalën “vëlla”, edhe pse ishte kundërshtari i tij në mendim.

- Borxhi im është 60 mijë dirhemë, - i tha Usama.

- Ma lër mua këtë gjë, - iu përgjigj Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

- Kam frikë se do të vdes, para se ta shlyesh atë, - foli Usama.

- Nuk do të vdesësh, deri sa unë të ta shlyej borxhin që ke.

Në këtë histori, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) na tregon se si të bashkëpunojmë me ata që kemi mendime dhe ide të ndryshme.

Fatkeqësisht, sot shohim njerëz, të cilët kanë mendime të ndryshme dhe jo vetëm që nuk i flasin njëri-tjetrit, por e urrejnë shumë njëri-tjetrin. Kjo dukuri negative ndodhet edhe në mesin e myslimanëve. Ne duhet të përdorim logjikën, intelektin në jetën tonë dhe jo të bazohemi te emocionet.

Në Kur'an thuhet: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”**⁵⁰

4- Ruajtja e krenarisë

Allahu e ka nderuar njeriun. Në Kur'an thuhet: **“Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit...”**⁵¹

Ajeti nuk thotë që i kemi nderuar besimtarët dhe as nuk thotë i kemi nderuar myslimanët, por thotë **“bijtë e Ademit”**, pra, të gjithë njerëzit. Njeriu është qenie e nderuar dhe e respektuar te Allahu dhe Allahu dëshiron që njeriu të jetojë i nderuar në këtë jetë. Për këtë duhet të marrim shembull Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili nuk pranoi të jetojë i poshtëruar dhe i zhveshur nga humanizmi. Ai u ngrit që të mbrojë humanizmin, të drejtat e njeriut. Kryengritja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte kryengritje ringjallëse dhe qëllimi i saj ishte të ringjallte ndërgjegjen e myslimanëve dhe të përhapte parimet dhe vlerat e larta njerëzore e morale, në të cilat besojnë të gjithë njerëzit.

Askush nuk ka të drejtë të poshtërojë krijesën e Allahut, me emrin njeri. Njeriu është mëkëmbësi i Allahut

⁵⁰ Sure “Huxhurat”, ajeti 10.

⁵¹ Sure “Isra”, ajeti 70.

në tokë, siç thuhet në ajetin 30 të sures “El Bekare”: **“Unë do të krijoj një məkëmbës** (që do të zbatojë ligjet e Zotit) **në tokë.”**. Duhet të jemi të pajisur me moralet e mira dhe me virtyte të larta.

5- Bujaria e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*)

Hasan Basriu ka thënë se Imam Hyseni, i biri i Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi ta!*), ka qenë zotëri, asket, vigjilent, punëmirë, këshillues dhe mbartësi i moralit të lartë.

Një ditë prej ditëve, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), së bashku me shokët e tij, shkuan te kopshti i tij (i Imam Hysenit). Në kopshtin e tij punonte një djalë, që quhej Safi. Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u afrua te kopshti, ai e pa djalin të ulur dhe po hante bukë. Imami u ul pas një hurme, që të mos e shihte djali. Ai pa se Safiu e ndante bukën përgjysmë me qenin. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u habit nga ky veprim i djalit. Kur djali mbaroi së ngrëni, tha me zë: “Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! O Zot! Më fal mua! Fale zotërinë tim dhe begatoje atë, ashtu siç i begatove prindërit e tij! Me mëshirën Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve!”

- O Safi! – i thirri Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*).

- O Zotëria im dhe zotëria i besimtarëve! – i foli djali i frikësuar, duke u ngritur që ta respektonte. - Të kërkoj ndjesë se nuk të pashë. Më fal mua.

- Më gjej rrugë zgjidhje o Safi, sepse unë hyra në kopshtin tënd pa leje!

- Ju lutem, zotëria im. Si e thua këtë? Këto janë falë mirësisë dhe bujarisë tënde.

- Unë të pashë që gjysmën e bukës e haje ti dhe gjysmën tjetër ia jepje qenit. Çfarë do të thotë kjo?

- Ky qen më shikonte mua, kur haja dhe unë u turpërova nga shikimi i tij. Ky është qeni yt, që ruan kopshtin tënd nga keqbërësit dhe unë jam robi yt. Të dy ne u ushqyen nga risku yt.

Kur dëgjoji këto fjalë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) qau dhe tha: “Ti je i lirë, për hir të Allahut! Unë do të të jap dy mijë dinarë me gjithë zemër”.

- Ti dëshiron të më lirosh, kurse unë dua të punoj në kopshtin tënd.

- Kur burri e thotë një fjalë, duhet ta vërtetojë me vepër. Unë të thashë, se hyra në kopshtin tënd, pa lejen tënde. Prandaj unë e vërtetova fjalën time dhe ta dhurova ty kopshtin, me gjithçka që ndodhet në të. Mirëpo shokët e mi erdhën, që të hanë diçka nga frutat dhe hurmat e kopshtit.

Pranoi ata si miqtë e tu dhe bujaroj ata për hatërin tim se Allahu do të të bujarojë ty në Ditën e Kiametit. Allahu e begatofte moralin dhe sjelljen tënde të mirë!

- Ti ma dhurove mua kopshtin tënd dhe unë e vendos atë në rrugën e shokëve dhe ndjekësve të tu.



ÇFARË BËRI UBEJDULLAH IBN ZIJADI?

Kur Ubejdullah ibn Zijadi mbërriti në Kufe, bëri këto veprime:

1- Kërkoi mbështetjen e pasuesve të emevitëve në Kufe.

2- Bleu me para njerëzit lakmitarë.

3- Me ndihmën e spiunëve të tij, arrestoi shumicën e udhëheqësve të lëvizjes ndarëse dhe njerëzit e rëndësishëm prej pasuesve të tyre.

4- Përdori politikën e joshjes e të terrorit ndaj njerëzve, për t'i larguar nga Myslim ibn Akijli.

5- Vrau Muslim ibn Akiljin.

6- Përgatiti ushtrinë për të luftuar Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Këtë ushtri e formoi me pasues të emevitëve, me ata që bleu me para dhe me ata me personalitet të dobët.

7- Udhëhoqi ushtrinë që formoi me ata që i bleu dhe i joshi me para e me poste të larta në qeverisje.

8- Një pjesë të ushtrisë e dërgoi për t'u përballur me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), para se ai të hynte në Kufe, ta bllokoni atë në një vend, ku të mos hynte dot dhe ta nxirrni nga Iraku. Ushtarët u takuan me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e rrethuan në Kerbela.

9- Pas rrethimit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) në Kerbela, Ubejdullah ibn Zijadi e dërgoi të gjithë ushtrinë që formoi, që të luftojë Imamin. Ushtria përbëhej prej dhjetëra mijëra ushtarësh. Ushtria e Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) kishte më pak se njëqind luftëtarë. Mes dy ushtrive filloi beteja dhe rezultati ishte martirizimi i Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), së bashku me shokët e tij. Kjo ndodhi, pasi komandanti i ushtrisë emevite i tha që të zgjidhte ose nënshtrimin ndaj udhëheqjes së Jezid bin Muavias, ose vrasjen dhe dërgimin e kokës së tij te Jezidi.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) zgjodhi martirizimin dhe kundërshtoi politikën e padrejtë e të shthurur të Jezidit. Ai zbatoi detyrën fetare, që e bën çdo mysliman, të sakrifkohet, kur dështojnë të gjitha mjetet, për të kundërshtuar devijimin e udhëheqjes emevite dhe padrejtësinë e tyre. Myslimanët duhet të përfitojnë nga sakrificat e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), për të kundërshtuar çdo udhëheqje të devijuar e të padrejtë.



KUSH E VRAU IMAM HYSENIN (*Paqja qoftë mbi të!*)?

Ibn Mendhuri thotë: “Kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) doli nga Meka, lajmi i mbërriti Jezidit. Ky i shkroi nëpunësit të tij në Irak, Ubejdullah ibn Zijadit dhe e urdhëroi që të luftonte me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ta vriste atë. I mallkuari Ubejdullah dërgoi ushtrinë drejt Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), në krye të së cilës ishte Umer ibn Sa’di. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ndryshoi drejtim dhe shkoi drejt Kerbelasë. Në Kerbela u takua me Umerin dhe bënë luftë. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u vra. Allahu e mallkoftë vrasësin e tij! Vrasja e tij ndodhi në datën dhjetë Muharrem, në vitin 61 Hixhri, Ditën e Ashures”.⁵²

Kjo thënie hedh poshtë pretendimet e armiqve të ndjekësve të Ehli Bejtit, të cilët thonë se ata (ndjekësit) e vranë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*).

⁵² Ibn Mendhur, “Mukhtasar Tarijkhu Dimashk”, vëll. 7, f. 145.



DITA E ASHURES, DITË MADHËSHTORE

Ashurja është ditë madhështore në historinë e myslimanëve, në përgjithësi dhe është ditë e dhimbshme për Ehli Bejtin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Është ditë madhështore, sepse Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), drita e syve të tij, imami legjitim i asaj kohe, i pesti prej anëtarëve të pastër të mbulesës prej Ehli Bejtit dhe përfaqësonte mesazhin e pastër islam që solli gjyshi i tij, i cili ka thënë: “*Hyseni është prej meje dhe unë jam prej Hysenit*”.

Beteja e Ashures ishte betejë mes të drejtës dhe besimit, që përfaqësohej me Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe mes padrejtësisë e tiranisë, që përfaqësohej nga Jezidi dhe mashat e tij.

Në ditën e Ashures u përsëritën betejat e të Dërguarve (*Paqja qoftë mbi ta!*) në përgjithësi dhe betejat e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në veçanti, si: Beteja e Bedrit, e Uhudit e

Ahزابëve etj. U përsëritën betejat e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): Beteja e Xhemelit, Beteja e Sifinit dhe Beteja e Nehrauanit.

Të gjithë të Dërguarit e Allahut, imamët, evlijatë, punëmirët, dëshmorët dhe muxhahidinët, kanë një qëllim të përbashkët: të luftojnë të keqen, padrejtësinë, injorancën, politeizmin, idhujtarinë e çdo forme, me qëllim që në mesin e njerëzve të sundojë drita e besimit, e drejtësisë, e dijes, e paqes dhe e dashurisë. Ky ishte edhe qëllimi i Revolucionit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i betejës së Kerbelasë.

I gjithë mosbesimi, injoranca, hipokrizia, shturja, poshtërsia, tradhtia, mendjemadhësia gjendeshin te ushtria emevite, e cila kërkonte hakmarrje për historinë e saj të zezë ndaj atyre 72 yjeve që qëndronin përkrah Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo ushtri gjakatare, me shpatat dhe shigjetat e saj, donte të shuante dritën e Allahut. Por ata nuk e dinin apo e kishin harruar, se Allahu i Madhëruar dëshiron që drita e Tij të vazhdojë dhe të mbulojë gjithçka. Askush nuk mund ta shuajë dritën e Allahut, sado që të përpiqet.

Edhe drita e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), edhe drita e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) kurrë nuk do të shuhet dhe flamuri i Ehli Bejtit gjithmonë do të valëvitet, deri në fund të kësaj jete.



Cilido që e përmend masakrën e Kerbelasë dhe e përcjell atë në mesin e njerëzve, inshalla, do të ketë shpërblim te Allahu dhe do të fitojë në Jetën Tjetër shefatin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Ehli Bejtit të tij.

Cilido që e shtrembëron këtë të vërtetë apo e fsheh atë, për interesa të ulëta të kësaj dynjaje, të mendohet mirë se çfarë e pret në Ditën e Gjykimit, kur të dalë para Allahut dhe Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Shenjtë:
“...Me siguri, Allahu dhe i Dërguari i Tij do t’i shohin veprat tuaja; pastaj ju do të ktheheni tek Ai, që i di gjërat e padukshme dhe të dukshme e do t’ju lajmërojë për atë që keni bërë.”.⁵³

⁵³ Sure “Et Teube”, ajeti 94.



PËRGJIGJE PËR PYETJET, DREJTUAR NDJEKËSVE TË EHLI BEJTIT

Pyetje 1

Përse ndjekësit e Ehli Bejtit (shi'itët) e përshëndesin Imam Hysenin me këtë mënyrë: “Es Selamu alejke ja Aba Abdilah”? Ata nuk duhet të thonë kështu, por të thonë: “Hyseni (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*)”, sepse ai është i vdekur dhe të vdekurit nuk i shkon selami.

Përgjigje 1

Së pari: Nëse selami nuk është i saktë për të vdekurit dhe nuk lejohet që atyre t’u çohet selam, atëherë, përse Allahu i Madhëruar thotë në Kur’anin e Shenjtë: **“Paqja qoftë mbi Ibrahimin!”**⁵⁴ **“Paqja qoftë mbi Nuhin!”**⁵⁵, ndërkohë që ata janë të vdekur?!

Së dyti: Ne e dimë që dëshmorët në rrugën e Allahut janë të gjallë, sepse kështu na thotë Kur’ani i Shenjtë, në ajetin 169 të sures “Ali Imran”: **“Kurrresi mos i quani të vdekur ata që janë vrrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të**

⁵⁴ Sure “Es Saffat”, ajeti 109.

⁵⁵ Sure “Es Saffat”, ajeti 79.

gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre.” Kështu që Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është i gjallë te Allahu dhe jo i vdekur dhe selami i shkon atij njësoj siç i shkon edhe gjyshit të vet, Profetit Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Pyetje 2

Betimi në emër të imamëve të pamëkatë është shirk, sepse ai është betim që bëhet jo në emër të Allahut. Përse ndjekësit e Ehli Bejtit betohen në emër të Hysenit?

Përgjigje 2

Nëse betimi nuk lejohet, veçse me emrin e Allahut të Madhëruar, përse vallë Allahu betohet në Kur'anin e Shenjtë në emër të gjërave të tjera, si: dielli, koha, fiku, dreka, vendet e yjeve etj?! Dihet se imamët e pamëkatë kanë pozitë më të lartë te Allahu se këto krijesa.

Pyetje 3

Përse pasuesit e Ehli Bejtit i shenjtërojnë dhe i puthin mezarët e imamëve të pamëkatë që ndodhen në Nexhef, në Kerbela, në Mashhad etj, sepse puthja e tyre është shirk (politeizëm)?

Përgjigje 3

Nëse puthja e gjërave të shenjta është shirk, përse vallë Profeti Jakub (*Paqja qoftë mbi të!*) e puthi këmishën e Profetit Jusuf (*Paqja qoftë mbi të!*), fshiu sytë e tij me atë këmishë dhe u shërua nga verbëria dhe iu rikthye shikimi?! E gjitha kjo ndodhi me këmishën e Jusufit! A bëri shirk Profeti i Allahut, Jakubi (*Paqja qoftë mbi të!*), kur puthi këmishën e Jusufit?! A bëri shirk Jusufi (*Paqja qoftë mbi të!*), kur i kërkoi përgëzuesit të Jakubit që t'ia vendoste këmishën e tij në fytyrë babait të tij (Jakubit), që t'i kthehej shikimi?!

Pyetje 4

Nuk lejohet kërkimi i përkrahjes dhe i ndihmës nga i vdekuri, sepse ky veprim është haram (i ndaluar) dhe shirk (politeizëm, idhujtari). Përse ndjekësit e Ehli Bejtit i kërkojnë ndihmë dhe përkrahje Imam Hysenit, ndërkohë që ai është i vdekur?

Përgjigje 4

Allahu i Madhëruar thotë: **“Kurrresi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre.”**⁵⁶ Pra, sipas këtij ajeti të bekuar, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) është dëshmori

⁵⁶ Sure “Ali Imran”, ajeti 169.

i umetit islam. Ai është mbreti i dëshmorëve, siç ka thënë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kështu që dëshmorët janë të gjallë. Prandaj, lejohet kërkimi i përkrahjes dhe i ndihmës prej tyre, ashtu siç u kërkohet njerëzve të gjallë.

Kuptimi i përkrahjes dhe i ndihmës është që Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) të bëjë shifat te Allahu i Madhëruar, sepse ai është prej të dashurve të Allahut dhe prej të zgjedhurve të Tij.

Pyetje 5

A e vranë shí'itët e Irakut Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*)? Kur diskutojmë me Ehli Sunetin çështjen e Kerbelasë dhe të Ashures, thonë se ata që e vranë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), ishin prej banorëve të Irakut, në mesin e të cilëve ishin: Shimr ibn Dhi El Xheushan, Khauli ibn Jezid El Asbahij dhe Senan ibn Enes. Cila është përgjigja për këtë?

Përgjigje 5

Përgjigjen e kësaj pyetjeje do të mundohemi ta sqarojmë nëpërmjet disa pikave.

Së pari: Atyre që pyesin rreth kësaj çështje, u themi: Le të jenë vrasësit e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) nga

Iraku, por ama ata nuk ishin nga shi'itët e tij, sepse fjala "shi'it" ka dy kuptime:

Kuptimi i parë: Shi'it është ai që beson në vilajetin (udhëheqjen) e Imam Husenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe beson se ai është imami i tretë. Bindja ndaj tij, me urdhër të Allahut, është e detyrueshme. Ai që beson në vilajetin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk mund të bashkohet kurrë me armiqtë e tij dhe të familjes së pastër të Profetit Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Kuptimi i dytë i fjalës "shi'it" është edhe për ata që e duan Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), për ata që pretendojnë dashurinë për Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe besojnë se ai është bashkëkohës (sahabi) dhe nipi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij*).

Së dyti: Në kohën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), jo të gjithë banorët e Kufes ishin shi'itë. Përkundrazi, në mesin e tyre kishte shumë nasibi (armiq të Ehli Bejtit), kishte havarixhë, shi'itë dhe suni. Sunitët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë së Kufes.

Me fjalën "suni" nënkuptojmë ithtarët e Sakifes, të cilët thonë se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), është kalifi i katërt i myslimanëve. Themi se ata

ishin prej medh'hebit Sakifi, sepse ai medh'heb ishte i përhapur në vendet islame në atë kohë.

Shi'itët, sipas kuptimit të parë që përmendëm më lart, ishin shumë të paktë në numër dhe rrallë mund të gjeje shi'it në Kufe, në atë kohë. Kjo për shkak se Muavia i shtypte shi'itët. Zijad ibn Ebijhi i përndiqte dhe i vriste shi'itët e Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ibn Ebi El Hadijd ka thënë se Ebul Hasan, Ali ibn Muhamed ibn Ebi Seif El Madainij ka transmetuar në librin "El Ahdath": "Pas vitit të zisë, Muavia u shkroi një letër mëkëmbësve të tij, duke u thënë se ai që transmeton diçka nga virtytet e Ebu Turabit (Imam Aliut) dhe familjes së tij, do të ndëshkohet. Predikuesit u ngritën në çdo rreth dhe në çdo minber, duke sharë Aliun, duke e mohuar atë dhe duke shpifur ndaj tij dhe familjes së tij. Njerëzit që u goditën më shumë në atë kohë ishin banorët e Kufes, për shkak të numrit të madh të pasuesve të Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), kështu që ai (Muavia) punësoi Zijad ibn Sumejen që të merrej me ta dhe i dha atij Basrën. Ai (Zijadi) i njihte shi'itët dhe i përndiqte ata, sepse ishte në mesin e tyre në kohën e Aliut, kështu që kudo që i shihte dhe i gjente, i vriste.

Gjithashtu, ai i frikësonte ata, ua priste duart dhe këmbët, ua nxirrte sytë, i kryqëzonte në trungjet e palmave dhe i dëbonte nga Iraku, kështu që nuk kishte mbetur asnjë i njohur prej tyre. Muavia u shkroi mëkëmbësve të tij në të gjitha rajonet, që të mos lejojnë askënd nga shi'itët e Aliut

dhe nga familja e tij që të dëshmojë... Ai u shkroi vartësve të tij, një kopje, në të gjitha vendet: 'Shikoni, kushdo që shprehet se e do Aliun dhe familjen e tij, fshijeni nga lista dhe hiqjani atij dhënien dhe furnizimin'. Kësaj shkrese i bashkëngjiti edhe këtë thënie: 'Ata që i akuzoni për dashuri e besnikëri ndaj këtyre njerëzve (Aliut dhe familjes së tij), ndëshkojini, që të shërbejnë si shembull për të tjerët'.

Nuk kishte fatkeqësi më të rëndë e më të madhe se kjo në Irak e veçanërisht në Kufe. Madje, kur një person nga shí'itët e Aliut shkonte tek ai, dikush që i besonte dhe i tregonte sekretin e tij, ai kishte frikë nga shërbëtori dhe skllavi i tij dhe nuk fliste me të, deri sa të bënte betimin e rëndë për ta mbajtur të fshehtë atë sekret...

Çështja vazhdoi kështu, deri sa vdiq Hasani, i biri i Aliut. Fatkeqësia dhe përndjekja u shtuan. Kështu që çdo njeri i frikësohej gjakut të tij apo dëbimit nga vendi".⁵⁷

Dhehebiu ka shkruar thënien e Ebu Sha'thait se Zijadi ishte më i egër se El Haxhaxhi, ndaj atyre që i kundërshtonin dëshirat e tij.

Hasan El Basriu ka thënë: "Hasani, i biri i Aliut, u informua se Zijadi po i përndiqte dhe po i vriste pasuesit e Aliut në Basra. Ai u lut për të".⁵⁸

⁵⁷ Ibn Ebi El Hadijd, "Sherh Nehxhul Belaga", vëll. 11, f. 46.

⁵⁸ "Sejru A'lamu En Nubelai", vëll. 3, f. 496.

Prandaj, në Kufe kishin mbetur vetëm disa shi'itë. Këta, ose dolën për të mbështetur Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*); ose ishin në burg, si Al Mukhtar dhe Meithem Et Tamar e të tjerë përveç këtyre të dyve; ose ishin të arratisur dhe të fshehur jashtë Kufes, nga frika e autoriteteve; ose u vranë, siç ndodhi me Muslim bin Akilin (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*).

Për të qenë më të qartë në këtë pikë, po paraqes përbërjen e shoqërisë së Kufes në atë kohë.



QYTETI I KUFES NË KOHËN E IMAM HYSENIT (*Paqja qoftë mbi të!*)

Prej çështjeve që meriton shqyrtim dhe hulumtim, është përbërja e ushtrisë që luftoi Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), elementet e saj shoqërore, prirjet e saj intelektuale dhe tekat e saj politike.

Burimet e historisë e kanë errësuar këtë aspekt dhe nuk kanë hedhur dritë të mjaftueshme mbi të dhe janë mjaftuar me deklarimin dhe nënkuptimin se ushtria ishte nga njerëzit e Kufes. Ata që i shkruan Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i dhanë besën Muslim ibn Akilit (i dërguar nga Imam Hyseni), ishin prej shi'itëve të Hysenit e më pas e prenë në besë, e tradhtuan dhe ia dorëzuan sundimit famëkeq.

Për t'u njohur me këtë çështje, kërkohet hulumtim i ndodhive, gjurmim i lajmeve rreth qytetit të Kufes, fiseve dhe grupeve që banonin në të. Gjithashtu, duhet studim për zhvillimet administrative dhe transformimet shoqërore që ndodhën në të.

Së fundi, duhet të shikohet mënyra e formimit të ushtrisë dhe e pajisjes së luftëtarëve, që u dërguan për të luftuar Imam Hysenin.

Këto studime, hulumtime e gërmime janë të domosdoshme, me qëllim që t'i jepet fund shpifjeve dhe përrallave të përhapura se Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) e vranë shí'itët e tij.

Shoqëria e Kufes nuk ishte shoqëri e sinqertë ndaj Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Në atë shoqëri ka pasur grupacione të ndryshme e të llojllojshme me prirje të ndryshme. Po përmendim më kryesoret prej tyre:

Grupi i parë: Myslimanët, që ishin shumica dërrmuese.

Grupi i dytë: Jehuditët, të cilët kishin lagje të tëra në Kufe.

Grupi i tretë: El Meualij (persët) apo humru e Dejlem, numri i cilëve arriti në Kufe njëzet mijë.

El Meulij përbënin një përqindje të lartë në shoqërinë e Kufes dhe, sipas një mendimi, ata kishin peshë dhe ishin më shumë se gjysma e popullsisë së Kufes. Ata monopolizuan zejtarinë, industrinë dhe tregtinë.

Grupi i katërt: Të krishterët.



Myslmanët në shoqërinë e Kufes, sipas besnikërisë së tyre, ishin të ndarë në disa grupacione:

1- Disa ishin prej ndjekësve (shi'itëve) të Imam Aliut, Imam Hasanit dhe Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

2- Disa ishin khauarixh.

3- Disa ishin njerëz lakmitarë dhe nxitës të përçarjeve.

4- Disa ishin prej atyre që dyshonin te Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nuk shihnin dallim mes tij dhe Jezidit.

5- Disa ishin prej atyre që mendonin se lufta bëhet për post.

6- Disa ishin prej ndjekësve (shi'itëve) të Muavias, të Umer ibn el Asit dhe Zubejrit.

7- Disa ishin fanatikë në fiset e tyre.

8- Disa ishin prej atyre që frikësoheshin për interesat e tyre.

9- Disa prej tyre mendonin se kishte konflikt historik mes fisit Hashimi dhe fisit Sufjani dhe ata nuk kanë punë me atë konflikt.

10- Disa ishin ateistë.

11- Disa prej tyre ishin umerijun, pra, prej besnikëve të kalifit të dytë.

12- Disa ishin dashamirës, por kishin besim të dobët. Këta gjenden në çdo grup fetar apo jofetar edhe në ditët e sotme.

13- Disa prej tyre ishin persë.

Ka dhe shumë fakte të tjera, grupacione e rryma të ndryshme, të cilat, për arsye vendi dhe trajtimin e çështjes, nuk po i përmendim këtu.

Pra, nëse kjo është shoqëria e Kufes, atëherë ushtria është vetëm pasqyrim i kësaj shoqërie që ka besnikëri dhe drejtime të shumta e të ndryshme. Prandaj, ata që e prenë në besë Imamin Hysenin dhe para tij, Imam Aliun dhe pas tij, Imam Hasanin (*Paqja qoftë mbi ta!*), nuk janë shí'itë, në kuptimin e atyre që besojnë në udhëheqjen e tyre, por ata ishin ajo përzierje që përmendëm në përbërjen e shoqërisë së Kufes në atë kohë.

Ato që përmendëm, i mbështesin edhe ndodhitë e shumta. Ne do të mjaftohemi me tre prej tyre:

1- Kur Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) gjatë kalifatit të tij donte të anulonte namazin e teravive (të cilin Omeri e shpiku), dikush nga banorët e Kufes thirri: “Ua sunete Omara!” Ah për sunetin e Umerit.

2- Kur Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) donte të shkarkonte Shurejhun, gjykatësin që ishte caktuar nga kalifi i mëparshëm, banorët e Kufes e refuzuan urdhrin e imamit dhe as Shurejhu dhe as njerëzit e Kufes nuk iu bindën atij (Imam Aliut).

3- Në kohën e Imam Hasanit (*Paqja qoftë mbi të!*) ushtria e tij dezertoi dhe shkoi te Muavia. Nuk u mjaftuan me kaq, por madje e sulmuan Imamin.

Këto tri ndodhi e të tjera si këto, sqarojnë se ata njerëz që vranë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ishin shi'itë të Imam Aliut apo të fëmijëve të tij.

Së treti: Kur lexojmë historinë, para ndodhisë së masakrës së Kerbelasë, veçanërisht po të lexojmë fjalimet e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), do të shohim se Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) e zbuloi identitetin e vrasësve të tij dhe vetë vrasësit e tij e zbuluan identitetin e tyre. Ai iu drejtua atyre duke thënë: “Mjerë ju! O shi'itë të familjes së Ebu Sufjanit, nëse nuk keni fe, nuk keni frikë nga Dita e Kiametit, nëse jeni arabë siç pretendoni, atëherë jini të lirë në botën tuaj dhe kthehuni në prejardhjet tuaja”.⁵⁹

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk u tha atyre: “O shi'itët tanë, pse dolët kundër nesh për të na luftuar?”

⁵⁹ Khauarizmit, “Maktelul Husejn”: vëll. 2, f. 38.

Në një ballafaqim tjetër me ushtrinë, Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) iu drejtua atyre: “Mjerë ju! Pse po më luftoni?! A për një të drejtë që e lashë apo për një sunet që e ndryshova, apo për një shariat që e ndërrova?!”

Ata thanë: “Përkundrazi, ne po të luftojmë për shkak të urrejtjes sonë ndaj babait tënd dhe për atë çfarë u bëri të mëdhenjve tanë në ditën e Bedrit dhe Hunejnit”. Kur dëgjoji fjalët e tyre, qau”.⁶⁰

Ju pyes për hir të Allahut: A mund të konsiderohet shí'it ai që e lufton Hysenin për shkak të urrejtjes që mbart ndaj Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut?! A keni parë ndonjë shí'it që e urren Ali ibn ebu Talibin (*Paqja qoftë mbi të!*)?!

Së katërti: Vrasësit e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ishin shí'itë. Ata vrasës ishin: Jezid ibn Muavia, Ubaidullah ibn Zijadi, Umer ibn Saad ibn Ebi Uekasi, Senan ibn Enesi, Harmala ibn Kaahil, Shimar ibn Dhil Xheushan, Shebth ibn Rab'i, Haxhxhar ibn Ebxher, El Husijn ibn Numijr Esh Shamij El Humsij e të tjerët. Pra, këta nuk ishin shí'itë. Thjesht pjesëmarrja e disa prej tyre në ushtrinë e Imam Aliut nuk tregon shí'izmin e tyre, sepse shumica prej tyre besonin se ai ishte kalifi i katërt dhe nuk besonin se ai ishte kalifi i parë, pas të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi*

⁶⁰ “Meusuatu kelimatul imamil Husejn”, f. 593. “Jenabkul Meuddeti” i Kanduzij.

i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), që të themi se ai është shí'it.

Së pesti: Pjesëmarrja e banorëve nga Shami në ushtrinë e Ibn Zijadit.

El Kulejni ka transmetuar nga Abdul Meliku: “E pyeta Ebu Abdullahun (*Paqja qoftë mbi të!*) për agjërimin e ditës së nëntë (tasu'a) dhe të ditës së dhjetë (Ashura) në muajin Muharrem. Ai tha: “Dita e nëntë (tasu'a) është dita kur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe shokët e tij (*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*), u rrethuan në Kerbela dhe kuajt e banorëve të Shamit u mblodhën rreth tij dhe i krekoseshin atij (Imam Hysenit). Ibn Merxhana dhe Umer ibn Sa’d u gëzuan nga prania e kuajve të shumtë. Ata e konsideruan Hysenin të dobët dhe ishin të sigurt se asnjë përkrahës nuk do të vinte te Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe populli i Irakut nuk do ta përkrahte atë”⁶¹.

El Saduku ka transmetuar: “Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) shikoi djathtas e majtas dhe nuk pa askënd. Pastaj ngriti kokën drejt qiellit dhe tha: ‘O Allah! Ti e sheh se çfarë po i bëhet djalit të Profetit tënd’.

Benu Kilab qëndroi midis tij dhe ujit. Ai u qëllua me një shigjetë, e cila e goditi në fyt dhe ra nga kali. Ai e nxori shigjetën dhe e hodhi. Më pas, filloi të priste gjakun me pëllëmbën e tij dhe, kur ajo u mbushte, lyente kokën dhe

⁶¹ Kulejni, “El Kafi”: vëll. 4, f. 147.

mjekrën, duke thënë: 'Të takoj Allahun i privuar dhe i lyer me gjakun tim'. Pastaj ai ra mbi faqen e tij të majtë. Te ai u afruan armiqtë e Allahut: Senan ibn Enes dhe Shimr ibn Dhil Xheushen el Amirij (*Allahu i mallkoftë!*) dhe burra nga populli i Shamit dhe qëndronin te Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*). Ata i thanë njëri-tjetrit: 'Çfarë prisni? Rehatojeni burrin (Imam Hysenin)'.

Sinan ibn Enes el Ajadi (*Allahu e mallkoftë!*) zbriti dhe e kapi mjekrën e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe filloi t'i godasë në fyt me shpatë, duke thënë: 'Pasha Zotin, do të ta pres kokën, edhe pse e di se ti je biri i të Dërguarit të Allahut dhe më i miri nga njerëzit, si nga babai, ashtu edhe nga nëna'.⁶²

Ka edhe shumë transmetime të tjera, që tregojnë pjesëmarrjen e ushtrisë së Shamit në Kerbela. Gjithashtu, ata ishin të pranishëm edhe në Kufe, në mëngjesin e martirizimit të Muslim ibn Akilit. Madje në ushtrinë e Umer ibn Sa'dit kishte njerëz nga Egjipti dhe Jemeni.⁶³

Së gjashti: Është përmendur në shumë tekste se shumë nga njerëzit e ushtrisë së Ibn Zijadit e lavdëronin Osman bin Afanin, se ai ishte osman, pra, në fenë e Osmanit.

⁶² "Amalij Saduk", f. 226.

⁶³ Shih: "Bugjetu Talabi", vëll. 6, f. 2571; "El Isti'abu", vëll. 1, f. 394; "Dhekhairul Ukba", f 250.

Et Tabariu ka transmetuar nga Hisham ibn Muhamedi, nga Ebu Mukhanafi atë që Jahja ibn Hani ibn Urvehi ka thënë: “Nafi ibn Hilali po luftonte atë ditë dhe thoshte: ‘Unë jam xhemeli (pjesëmarrës në luftën e Xhemelit)! Unë jam në fenë e Aliut!’ Pastaj një njeri, Muzahem Ibn Harith, doli tek ai dhe i tha: ‘Unë jam në fenë e Osmanit!’

Ai (Nafiu) i tha: ‘Ti je në fenë e shejtanit!’

Pastaj e sulmoi dhe e vrau atë”.⁶⁴

Rezultati: Pjesëmarrja e shi’itëve në vrasjen e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk është vërtetuar me prova. Ato trumbeta që kërcasin e bori që buçasin, se shi’itët e vranë Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) janë veçse zërat e armiqve të familjes së pastër të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Këta duan ta mbajnë të ndezur fitilin dhe përçarjen në mesin e myslimanëve.

Më e keqja është se këta pretendojnë se do të hyjnë në Xhenet. Vallë, nëse realizohet pretendimi i tyre, gjë që është e largët, a e kanë përgatitur përgjigjen, kur të shohin në Xhenet Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili është zotëria i të rinjve të banorëve të Xhenetit? A nuk e dinë këta se e drejta e një njeriu tjetër (haku nasi) është më i rëndë se e

⁶⁴ “Tarijkhu Tabari”, vëll. 4, f. 331.

drejta ndaj Allahut (hakkullahi)? Çfarë qëllimi kanë këta me përhapjen e kësaj shpifjeje të rëndë? Kujt i shërbejnë këta?

Mendoni thellë, o njerëz të arsyeshëm!

TË DHËNA RRETH UDHËTIMIT TË IMAM HYSENIT (*Paqja qoftë mbi të!*)

Rruga tokësore që përshkoi Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) nga Meka për në Kerbela ishte e gjatë 1470 kilometra.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) doli nga Meka ditën e martë, më 8 Dhul Hixheh, 60 Hixhri.

Ai mbërriti në Kerbela ditën e enjte, më 2 muharrem, 61 hixhri.

Numri i zonave, nëpër të cilat kaloi Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte 38.

Numri i vendeve, nëpër të cilat kaloi Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*), po nuk qëndroi në to, ishte 14.

Numri i vendeve, nëpër të cilat kaloi Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ka qëndruar në to, ishte 24.

Numri i ditëve, në të cilat udhëtoi Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte 23 ditë (21 ditë në muajin Dhul Hixhe dhe 2 ditë në muajin Muharrem).

Rrugën për në Hixhaz e bëri për 14 ditë, ndërsa rrugën për në Irak e bëri për 9 ditë.

Shpejtësia mesatare me të cilën ka ecur Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) në një ditë ka qenë 63.91 kilometra në ditë.

Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) u martirizua në ditën e dhjetë të muajit Muharrem, 61 Hixhri, në tokën e Kerbelasë.

ÇFARË PE NË ZIARETIN E TË DYZETAVE TË IMAM HYSENIT (*Paqja qoftë mbi të!*)?

E pyetën një person: “Çfarë pe në ziaresin e të dyzetave të Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*)?”

Ai tha: “Pashë doktorin, duke u fërkuar këmbët vizitorëve.

Pashë një djalë, që kishte mbaruar universitetin dhe po pastronte rrugën.

Pashë kryetarin e fisit, që u lutej njerëzve t’u shërbente atyre për gjithçka që dëshironin.

Pashë hoxhën të ulur në tokë dhe u përgjigjej pyetjeve të njerëzve.

Pashë fëmijën e vogël të buzëqeshur e të palodhur, edhe pse kishte ecur shumë.

Pashë burra të moshuar e të palodhur, që garonin të rinjtë në ecje.

Pashë femra të mbuluara, të respektuara dhe krenare,
edhe pse lodhja dukej tek ato.

Pashë të varfrin, që ushqente të pasurin, në emër të
Hysenit.

Pashë të sëmurin, që i shërbente të shëndetshmit, në
emër të Hysenit.

Pashë dashurinë, përmallimin, të vërtetën, sakrificën
dhe sinqeritetin.

Pashë të gjithë bukuritë në rrugën e mirësisë.

Pashë shpresën, që rritej dhe dhimbjen që pakësohej.

Pashë një popull të plagosur, që përqafonte mbarë
botën, në emër të shehidit të Kerbelasë, që marshonte drejt
tij.

Selamu alejke ja Imam Hysen!

Kurrë nuk do të të braktisim, o Imami ynë, Hysen!

O Zoti ynë! Na e mundëso ziaretin e Imam Hysenit
në këtë jetë dhe shefatin e tij në Jetën Tjetër!



KUSH ËSHTË MUAVIA?

Shejkh Hasan Ferhan El Malikij, një prej profesorëve të fik'hut në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe prej dijetarëve të Ehlu Sunneh uel Xhema'atu, thotë: “Habitem me disa njerëz, të cilët thonë se e duan Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në të njëjtën kohë lavdërojnë persona që gjatë gjithë jetës së tyre e luftuan të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), Ehli Bejtin dhe shokët e tij përgjatë 80 viteve.

Muavia ka lindur pesë vjet para se Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) t'i zbriste profecia. Që në vogëli ai u ushqye me urrejtjen ndaj Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Babai i tij ka qenë Ebu Sufjani. Nëna e tij është Hindi, ngrënësja e mëlçisë së Hamzait. Halla e tij ishte Hamaletul Hatab (mbartësja e druve).

Në kohën që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte në Mekë, Muavia ka qenë prej atyre të rinjve që kurejshët i nxitnin që ta

lëndonin të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Ai, bashkë me babanë e tij, kanë marrë pjesë në luftërat kundër Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Në luftën e Bedrit u vra vëllai i tij, Handhalah, të cilin e vrau Aliu. Gjithashtu u vranë dy gjyshërit e tij, Utbetu dhe Shejbetu, si dhe daja i tij, Uelijdi.

Më pas, në ditën e çlirimit të Mekës, ai e pranoi Islamin me hipokrizi.

Mori pjesë si hipokrit në Betejën e Hunejnit. Së bashku me babanë e tij u veçuan në majë të kodrës dhe thoshin: “Sot u prish magjia!”

Në Betejën e Hunejnit, ai dhe babai i tij, i vodhën devenë një të moshuare myslimane. Ajo iu ankua Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) për ata të dy. Ata e mohuan vjedhjen dhe u betuan. Por, Allahu e lajmëroi Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) për vendin se ku e kishin fshehur devenë. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i qortoi ata të dy dhe ia ktheu devenë të moshuarës.

Në Tebuk, Muavia dhe babai i tij u përpoqën të vrasin Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), në Akabetin e Tebukut. Por Allahu e mbrojtë. Historinë e planit të vrasjes e ka përmendur Allahu

në Librin e Tij: “...dhe synuan të bënin gjëra të paarritshme.”⁶⁵

Me Muavian dhe Ebu Sufjanin kishte edhe burra të tjerë numri i të cilëve ishte katërmbëdhjetë burra. Ai i mallkoi ata.

Pasi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u kthye nga Tebuku, i nxori nga xhamia ata që donin ta vrisnin. Prej tyre ishte Ebu Sufjani dhe dy djemtë e tij, Muavia dhe Atebetu.⁶⁶

Në kohën e Osmanit, Muavia bëri ixhtihad në grumbullimin e pasurive dhe në shtypjen e punëmirëve, duke përdorur kamatën (err rribau).

Në kohën e Aliut, ai vrau 25 persona që morën pjesë në Betejën e Bedrit dhe rreth 200 prej sahabëve që morën pjesë në Besëlidhjen e Ridvanit (Bej'atu err Rriduan) në Sifijn.

Po në kohën e Aliut, Muavia e ka mallkuar atë (Aliun) nëpër minbere, shtypi përkrahësit, hapi varrin e Hamzait dhe urdhëroi një nga punonjësit e tij që të godasë këmbën e Hamzait, i cili vrau gjyshin e tij, Atabetu.

⁶⁵ Sure “Teube”, ajeti 74.

⁶⁶ Zinxhiri i transmetimit (senedi) i kësaj historie është i rregullt (sahih).

Ai (Muavia) donte të shkatërronte minberin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Këtë e bëri dy herë. Por qielli u errësua, kur deshi ta bënte dhe ai e la këtë veprim.

Muavia shkoi ne Ebva dhe deshi të hapte varrin e nënës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe ta hidhte në pus. Allahu e goditi me sëmundjen e deformimit të fytyrës dhe nuk e bëri.

Fundi i tij ishte, ashtu si ka thënë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*): “Muavia do të vdesë jo prej umetit tim”.⁶⁷

Për atë (Muavian) u vërtetua edhe një hadith tjetër, hadithi i Ed Dubejletu (lungës), e cila iu shfaq atij në shpinë dhe i kaloi te kraharori. Ai qëndroi me këtë torturë plot një vit.

Në Sahihun Muslim, në hadithin e Kajs ibn Imad nga Amri, thuhet: “Tetë persona do të goditen me lungën (ed dubejletu), sëmundje që shfaqet në shpinat e tyre dhe kalon në kraharorët e tyre”.

⁶⁷ Hadithi është i rregullt, sipas kushtit të Muslimit. Këtë hadith e ka quajtur të rregullt Xhamiatul Ummul Kurra.

Muavia nuk vishte çdo lloj veshjeje. Atij i punuan një veshje prej gushave të zogjve. Edhe kjo i dukej e rëndë dhe e lëndonte. Kur sëmundja dhe rënkimet e tij zgjatën dhe nuk po shërohej, doktori e këshilloi të vendoste kryqin dhe të hiqte dorë nga feja e Muhamedit. Ai e bëri këtë dhe vdiq.

Ky është Muavia, që keni mbushur dynjanë me gënjeshtër e trillime ndaj Allahut dhe Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), duke e lavdëruar atë. I keni vendosur cilësi të kota, që nuk i pëlqen Allahu. Madje e keni quajtur daja i besimtarëve.

Mjafton vetëm një hadith për ta fajësuar atë. Ai hadith është: “Muavia nuk do të vdesë në fenë time”.⁶⁸

Autori: Hasan ibn Ferhan El Malikij

⁶⁸ “Ensabul Arabi” i El Beladherij, vëll. 1, hadithi numër 1518, me zinxhir transmetimi të saktë sipas kushtit të Muslimit. Ky hadith i largon të gjitha debatet. Transmetuesit e këtij hadithi janë të besueshëm (thukatë) dhe e kanë dëgjuar nga njëri-tjetri. Këtë hadith e ka quajtur të rregullt një grup hadithologësh, sipas kushtit të Muslimit. Prej atyre hadithologësh janë: Muhamed ibn Azuuz El Mekki dhe ibn Akijli.



BËMAT E MUAVIUT NË LIBRAT E EHLLI SUNETIT

1- Muaviu është prej të liruarve në vitin e çlirimit të Mekës. Ammar ibn Jasir ka thënë se ata që u falën në ditën e çlirimit të Mekës nuk e pranua Islamit por ata u dorëzuan. (El Beladherij në librin Futuhul Buldan, vëllimi 3, faqe 582).

2- I Dërguari i Allahut e ka mallkuar atë. (El Hejthemij në Mexhmau Zeuaid, vëllimi 1, faqe 113. Musned El Bezar, 3246).

3- I Dërguari Allahut ka thënë për Muaviun në një lutje (dua): Allahu mos ia ngoptë barkun. (Sahihu Muslim, 2604).

4- I Dërguari i Allahut ka thënë për atë: Nëse i shikoni Muaviun në minberin tim, vriteni atë. (Ibn Habban në Kitabul Mexhruhijne, vëllimi 1, faqe 157 dhe vëllimi 2, faqe 172.).

5- Aisheja e ka quajtur: el faxhiru (imoral, epshor, i shthurur, i shfrenuar, i dhënë pas qejfeve). (Ibn Kethijr në El Bidajetu ue Nihajetu, vëllimi 3).

6- Muaviu shante Aliun ndërkohë që i Dërguari i Allahut ka thënë: Ai që e shan Aliun më ka sharë mua dhe kush më shan mua ka sharë Allahun. (Sunen Ibn Maxheh, 121. El Bidajetu ue Nihajetu, i Ibn Kethijr Ed Dimashkij, vëllimi 11, faqe 50. Ahmed ibn Hanbel, 6/323. El Xhamiu Sagijr i Sujutit, 8736).

7- Ka vrarë En Nisai, autori i librit Sunenu Nisai, që është prej fakihave të mëdhenj të Ehli Sunetit. Ai u vra sepse nuk transmetoi asnjë virtyt të Muaviut. (El Bidajetu ue Nihajetu, i Ibn Kethijr Ed Dimashkij, vëllimi 14, faqe 794).

8- Muaviu nuk meriton asnjë virtyt. (Edh Dhehebij në librin Sejru A'lamu En Nubela, vëllimi 3, faqe 132).

9- Ai nuk ka qenë prej shruesve të Mesazhit sepse transmetimi i tij nuk është i saktë e as i vlefshëm sipas pohimit të Neueuijut. (Sahihu Muslim bi sherhi Neueuij, faqe 51).

10- Ai ka pirë alkol pasi ka pranuar islamin. (El Hejthemij në librin Mexhamu Zeuaid, vëllimi 5, faqe 42).

11- Ai ka vrarë Ammari një prej sahabëve të njohur për të cilin i Dërguari i Allahut ka thënë: Ammarin do ta vrasë një grup mëkatar i padrejtë. (Sahihu Muslim, 2916).

12- Ai ka vrarë sahabiun Hixhr ibn Udej. (Ibn Haxher në librin El Isabetu, vëllimi 2, faqe 32).

13- Ai ka vrrarë Maliku Eshterin (El Hameuij në Librin Mu'xhemul Bulvan, vëllimi 1 faqe 454).

14- Ai ka djegur Muhamed ibn Ebu Bekr, vëllai i Aishesë. (Ibn El Ethijr në librin Usdul Gabeti, vëllimi 4, faqe 324).

15- Muaviu ka vrrarë shumë prej mëkëmbësve të Aliut në Hixhaz, në Jemen dhe mes tyre Amru ibn Umejs ibn Mes'ud. (Ibn Haxher në librin El Isabetu, vëllimi 1, faqe 221; vëllimi 4 faqe 551 dhe vëllimi 5 faqe 546.) .

16- Ka therur dy fëmijët e Ubejdullah ibn Abbas ibn Abul Mutalib. Ka djegur shtëpinë e Zuraretu ibn Hajrun dhe shtëpinë e Refaatu ibn Rrafiu dhe shtëpinë e Abdullah ibn Sa'ad. Ka vrrarë njerëz nga beni Ka'ab mes Mekës dhe Medines dhe i hodhi në pus. Dërgoi Bisr ibn Ebi Erta'atu në Medine dhe shembi shumë shtëpi. Atje dontë të bënte një masakër në Xhami. (Ibn Asakir n Tarijkhu Medineti Dimashk, vëllimi 10 faqe 151-152 dhe vëllimi 19, faqe 172. Ibn Haxher në El isabetu, vëllimi 1 faqe 221, vëllimi 4 faqe 551 dhe vëllimi 5 faqe 543).

17- Ka marrë skllave myslimane dhe i ka shitur në tregun e skllaveve. Kjo ka ndodhur për herë të parë në Islam. (Muxhtemau Jethrib i Khalijl Abdul Kerijm, faqe 63).

Ai ka vrrarë banorët e Adhrau. Për këtë Aisheja ka thënë se i Dërguari i Allahut ka thënë: Në Adhra do të vriten

njerëz ku Allahu dhe banorët e qiellit do të zemërohen ndaj vrasësve. (Ibn Kethijr në librin Eli Bidajetu ue Nihajetu, vëllimi 11, faqe 241).

18- Muaviu ka varrosur të gjallë Abdurrahman ibn Hassan El Anzj. (El A'lam i Khajrudijn Ez Zerkelij, vëllimi 3 faqe 303 dhe vëllimi 4 faqe 207).



PËRSHTYPJE PËR JEZIDIN, TË BIRIN E MUAVIAS

El Jafiu ka thënë: “Ai që vrau Hysenin apo urdhëroi vrasjen e tij, si dhe ai që e lejoi këtë, është i pafe (kafir)”.⁶⁹

Dhehebiu ka thënë për Jezidin: “Ka qenë nasibijun (armik i Ehli Bejtit), vulgar, i ashpër dhe i paedukatë. Pinte alkool. E filloi qeverisjen e tij me vrasjen Hysenit dhe e përfundoi me ndodhinë El Hur'retu”.⁷⁰

Ibn Kethiri ka thënë: “Jezidi ishte prijës i shturur”.⁷¹

El Mes'udi ka thënë: “Kur njerëzit i përfshiu padrejtësia e Jezidit dhe e nëpunësve të tij, kjo padrejtësi u përhap në mesin e tyre. Prej shturjes së tij të dukshme është vrasja që i bëri djalit të vajzës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe përkrahësve të tij. Jeta e tij ka qenë si e Faraonit, madje

⁶⁹ Ibn El Imad El Handelij, “Shedherat mine Dhehebi”, vëll. 1, f. 68.

⁷⁰ “Sijer El A'lami En Nubelai” i Dhehebiut, vëll. 4, f. 37

⁷¹ “El Bidajetu ue En Nihajetu”, vëll. 8, f. 223.

Faraoni ka qenë më i drejtë se ai ndaj masës së tij dhe më i drejtë se ai ndaj njerëzve të tij të veçantë...⁷²

El Xhahidhu ka thënë: “Të ndaluarat që i vepronte Jezidi, fillojnë me vrasjen e Hysenit, marrja robëresha vajzat e të Dërguarit të Allahut, goditja e buzëve të Hysenit me shkop, kërcënimi që u bëri banorëve të Medines, shembja e Qabes. Këto tregojnë ashpërsinë e tij, zemërgurtësinë e tij, armiqësinë e tij, mendimin e keq të tij, urrejtjen, hipokrizinë dhe daljen nga besimi. I shtururi është i mallkuar. Ai që ndalon ofendimin e të mallkuarit, është i mallkuar”.⁷³

⁷² “Muruxhu Dheheb”, vëll. 3, f. 82.

⁷³ El Xhahidhu, “Err Rrisaletu El Hadijetil ashr fi beni ummejeti”, f. 398.



PËRGËZIME SHI'ITËVE⁷⁴

Çfarë i bën shi'itët të durueshëm nga ky lëndim i vazhdueshëm, për më shumë se katërmbëdhjetë shekuj? A nuk është dashuria e tyre e sinqertë për Muhamedin dhe familjen e tij, që i bën ata të durueshëm?

Ata janë të përlulur e modestë. Sa e shtrembëruar është paraqitja e tyre! Është e vërtetë që disa nga simbolet e tyre unë i njihja më parë, por t'i shohësh nga afër ata, është edhe më mirë.

Përgëzime shi'itëve për këtë vetëpërmbytje e durim ndaj lëndimit, shpifjes ndaj nderit dhe lumit të ofendimeve, me të cilat ata përballen, për shkak të dashurisë së tyre për familjen e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që me të vërtetë është një nder i madh.

Thashë me vete: Pse do ta duronin këtë lëndim, që ka zgjatur më shumë se katërmbëdhjetë shekuj? A nuk është

⁷⁴ Hasan Ferhan El Malikij.

dashuria tyre e sinqertë për Muhamedin dhe familjen e tij që i bën ata të durueshëm?

Çdo ditë ata presin me gjokset dhe fytyrat e tyre shigjetat e padrejta prej akuzave ndaj tyre siç janë thëniet se ata janë mexhusë, bijtë e mu'asë (martesës së përkohshme), janë të ndytë, e të tjera akuza. E kjo për shkak të dashurisë së tyre për familjen e Muhamedit.

A nuk kanë të drejtë të thonë në Ditën e Kiametit: “Na vranë, na akuzuan në nderin tonë, na përbuzën gjatë këtyre shekujve, vetëm e vetëm se ne e donim familjen e Muhamedit”.

Kundërshtarët e shi'itëve nuk mjaftohen me kritikën e gabimeve të tyre apo të anomalive të disave prej tyre, përkundrazi, ata i akuzojnë të gjithë dhe shpifin për nderin e tyre në përgjithësi. Kjo është vetëm për shkak të dashurisë për familjen e Muhamedit.

Shi'itët janë pjesmarrës me profetët në këtë ndotje të reputacionit të tyre. Ata sakrifikuan dinjitetin e tyre dhe e shpenzuan reputacionin e tyre për hir të Allahut, i Cili thotë:

هَلْ يَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...”⁷⁵

Vërtet, durimi i shi’itëve ndaj çdo persekutimi, vrasjeje, shpërnguljeje, fyerjeje, risie dhe heretizmi gjatë këtyre shekujve është i mahnitshëm dhe mbresëlënës. Çfarë zemrash mbartin ata?!

Si mundën t’i ruanin moralet e mira me gjithë këto fyerjeve, padrejtësi dhe provokime?! Sigurisht, ato janë zemra plot dashuri për Aliun, ndaj janë të sigurtat!

Dy grupe do të vijnë në Ditën e Kiametit, të cilët janë pjesmarrës në shpenzimin e reputacionit dhe të pozitës së tyre, për hir të Allahut. Ato dy grupe janë: Profetët dhe pasuesit e tyre, si dhe Ehli Bejti dhe ndjekësit (shi’itët) e tyre. Ata janë triumfuesit!

Është e drejta e shi’itëve, që në Ditën e Kiametit të krenohen dhe t’i thonë Imam Aliut dhe Zehrasë: “Për hir të dashurisë për ju, ne na persekutuan, na dëbuan, na akuzuan për nderin tonë dhe na bënë të shijojmë hidhësinë”.

Ata (shi’itët) kurrë nuk do të turpërohen në Ditën e Kiametit, sepse nuk i donin hipokritët, tiranët dhe thirrësit në Xhehenem. Në librin e veprave të tyre nuk mund të gjesh dashurinë e tyre për të padrejtët.

⁷⁵ Sure “Ali Imran”, ajeti 92.



Sa për ne (sunitë), do të dalim në Ditën e Kiametit dhe në librat e veprave tona gjendet dashuria për hipokritët dhe zullumqarët, si Muavia, Haxhaxhi, Jezidi dhe Muteuekeli. Kush do të diskutojë me Allahun, në emër të tyre (shi'itëve) në Ditën e Kiametit?

Tani është koha për t'i kuptuar shi'itët. Të kuptohet se të gjitha mallkimet, sharjet, ofendimet dhe frikësimet kurrë nuk sjellin dobi.

Ah, sikur ne të mësojmë prej tyre këtë durim, moral dhe shpirt!

Përgëzime shi'itëve!



ZIARETI I IMAM HYSENIT **(Paqja qoftë mbi të!)**

BISMILAHİ RRAHMANI RRAHIJM

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

ALLAHUMME SAL'LI ALA MUHAMEDIN UE ALII
MUHAMED

O Zot! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit!

ES SELAMU ALEJKE JA ABA ABDILAH

Paqja qoftë mbi ty, o babai i Abdullahut!

ES SELAMU ALEJKE IBNE RESULILAH

Paqja qoftë mbi ty, o biri i Dërguarit të Allahut!

ES SELAMU ALEJKE IBN EMIREL MU'MININ

Paqja qoftë mbi ty, o biri i Prijësit të besimtarëve!

ES SELAMU ALEJKE IBNE FATIMETE ZAHRA SEJJIDETI
NISAIL ALEMIJN

Paqja qoftë mbi ty, o biri i Fatime Zehrasë, zonja e grave të botëve!

ES SELAMU AELJEK JA ABA EIMMETI EL HADIJINE EL MEHDIJJIN

Paqja qoftë mbi ty, o babai i imamëve të udhëzuar dhe udhëzues!

ES SELAMU ALEJKE JA SARIJ'A ED DEM'ATI ES SAKIBEH

Paqja qoftë mbi ty, o i vrarë, që lotët nuk ndalojnë (për ty)!

ES SELAMU ALEJKE JA SAHIBEL MUSIJBETI ERR RRATIBEH

Paqja qoftë mbi ty, o vuajtësi i fatkeqësisë së përhershme!

ES SELAMU ALEJKE UE ALA XHEDDIKE UE EBIJKE

Paqja qoftë mbi ty, mbi gjyshin tënde dhe mbi babain tënd!

ES SELAMU ALEJKE UE ALA UMMIKE UE EKHIJKE

Paqja qoftë mbi ty, mbi nënën tënde dhe mbi vëllanë tënd!

ES SELAMU ALEJKE UE ALAL EIMMETI MIN DHURRIJJETIKE UE BENIJKE

Paqja qoftë mbi ty, mbi imamët prej gjenezës tënde dhe prej fëmijëve të tu!

ESH'HEDU LEKAD TAJJEBE ALLAHU BIKE ET TURABE

Dëshmoj se me ty Allahu e mirësoi tokën!

UE EUDAHA BIKE EL KITAB

Nëpërmjet teje e sqaroi Librin (Kur'anin).

UE XHEALEKE UE EKHAKE UE XHEDEKE UE EBAKE
UE UMMUKE UE BENIJEKE IBRETEN LIL ULIL ELBABA
IBNEL MEJAMIJNE EL ETJABE ET TALIJNE EL KITABE

Të ka bërë ty, vëllanë tënd, babanë tënd, nënën tënde dhe fëmijët e tu shembull për t'u ndjekur. O i biri i të begatshmëve, i të pastërve dhe lexuesve (sqaruesve) të Librit!

UEXHEHTU SALAMI ILEJKE SALAUATULLAHI ES
SELAMUHU ALEJKE

Selamin tim ta drejtoj ty! Selami i Allahut dhe bekimi i Tij qofshin mbi ty!

UE XHEALE EF'IDETI MINE NASI TEHUIJ ILEJKE

Ai ka bërë që zemrat e njerëzve të të duan ty!

MA KHABE MEN TEMESEKE BIKE UE ILTEXHE'EILEJKE

Nuk humbet ai që kapet me ty dhe strehohet te ti!

SAL'LALLAHU ALEJKE UE ALA EKHIKE EBIL FADLI
ABAS

Paqja e Allahut qoftë mbi vëllanë tënd, Abul Fadl Abasin!

UE ALA UKHTIKE UMMUL MESAIBI ZEJNEB

Paqja e Allahut qoftë mbi motrën tënde, ummul mesaib,
Zejneb!

UE ALA UELEDEJKE ALIJEJNI ESH SHEHIDEJNI

Paqja e Allahut qoftë mbi dy fëmijët e tu, Aliun e madh dhe
Aliun e vogël!

UE ALA IBNI EKHIKE KASIM

Paqja e Allahut qoftë mbi djalin e vëllait tënd, Kasemin!

UE ALA IBNI AMIKE UE SEFIJREKE MUSLIM IBN AKIJL

Paqja e Allahut qoftë mbi djalin e xhaxhait tënd dhe
ambasadorin tënd, Muslim ibn Akijlin!

UE ALAL MUSTESH'HEDIJNE BEJNE JEDEJKE
XHEMI'AN UE RAMETULLAHI UE BEREKATUHU

Paqja e Allahut qoftë mbi të gjithë dëshmorët që u
martirizuan me ty!

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

Paqja qoftë mbi Imam Hysenin!

Paqja qoftë mbi Aliun, i biri i Imam Hysenit!

Paqja qoftë mbi heroinën e Kerbelasë, hazretin Zejneb!

Paqja qoftë mbi heroin e Kerbelasë, Ebul Fad Abasin!

Paqja qoftë mbi fëmijët e Imam Hysenit!

Paqja qoftë mbi përkrahësit e Imam Hysenit!

Paqja qoftë mbi të gjithë ata që e pasojnë me devotshmëri rrugën e Imam Hysenit!

Allahu i mëshiroftë ata sy që vajtojnë për Imam Hysenin!

Allahu i forcoftë ato zemra që mbartin dashurinë për Imam Hysenin!

Allahu i ndriçoftë ato mendje që e njohin ashtu siç duhet Imam Hysenin!

O Allah i Plotfuqishëm! Na mundëso të jemi në rrugën e Imam Hysenit, e cila është rruga e gjyshit të tij, Profetit Muhamed dhe na bashko me ta në Ditën e Kiametit!

O Zot i Plotfuqishëm, për hir të kësaj dite madhështore, na i forco zemrat dhe gjymtyrët në rrugën Tënde dhe në rrugën e të zgjedhurve të Tu, në këtë jetë dhe na bashko me ata në Jetën Tjetër!



LUTJE

O Allahu ynë!

Të lutemi Ty, që për hir të kurbetit të Imam Hysenit!

Për hir të etjes së Imam Hysenit!

Për hir të duarve të prera të Abaz Aliut!

Për hir të durimit të zonjës Zejneb!

Për hir të gjakut të Abdullahut të vogël!

Për hir të kokave të prera të dëshmorëve të Kerbelasë!

Për hir të trupave të shtypur e të masakruar të dëshmorëve të Kerbelasë!

Për hir të të sëmurit në Kerbela, Imam Zejnul Abedinin!

Shëroji të sëmuret tanë!

Ruaji fëmijët tanë dhe familjet tona!

Ndryshoje gjendjen tonë të keqe me gjendjen Tënde të mirë!

Mëshiroi të vdekurit tanë!

Na i largo vështirësitë dhe problemet!

Na forco në rrugën Tënde dhe në rrugën e të dashurve të Tu!

Na bashko me të dashurit e Tu në Jetën Tjetër!

O Sundues! O Falës! O Mëshirues! O Lehtësues i vështirëve!
O Zot i botëve!

Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit!



عاشوراء رسالة الإصلاح والوحدة

تيرانا 2023

اسم الكتاب: عاشوراء رسالة الإصلاح والوحدة

الإعداد: الحاج الشيخ ولنت مريا

التصحيح اللغوي: يريدا كولا

الإخراج النهائي: صبريه فزا

الغلاف: إسراء مريا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا